



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

[www.qpz.gov.al](http://www.qpz.gov.al)

**Nr.39**

**15 prill**

**2011**

## P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Udhëzim i MF dhe MPPT nr.122, datë 26.1.2011	Për përcaktimin e tarifave të shërbimit në Autoritetin Portual Durrës ..... 1671
Urdhër i BSH nr.1763, datë 28.2.2011	Mbi miratimin e dy projektudhëzimeve të propozuara nga Këshilli Drejtues i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave ..... 1689

**UDHËZIM**  
**Nr.122, datë 26.1.2011**

**PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE TË SHËRBIMIT NË AUTORITETIN PORTUAL DURRËS**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, nenit 84 të ligjit nr.9251, datë 8.7.2004 “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë”, Ministri i Financave dhe Ministri i Punëve Publike dhe Transportit, me propozim të Këshillit Drejtues të Autoritetit Portual Durrës, me vendimin nr.36, datë 22.12.2010,

**UDHËZOJNË:**

1. Tarifat për shërbimet në Autoritetin Portual Durrës caktohen sipas lidhjes që i bashkëlidhet këtij udhëzimi dhe është pjesë përbërëse e tij. Niveli i tarifës për shërbimet është shprehur pa TVSH.

2. Institucioni përgjegjës për vjeljen e tarifave është Autoriteti Portual Durrës ose subjekte të autorizuar prej tij.

Ky udhëzim hyn në fuqi në datën 20.2.2011 dhe botohet në Fletoren Zyrtare në numrin më të parë të radhës.

Udhëzimi nr.442/2, datë 12.3.2010 shfuqizohet.

**MINISTRI I FINANCAVE**  
**Ridvan Bode**

**MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE**  
**DHE TRANSPORTIT**  
**Sokol Olldashi**

**TARIFAT E PORTIT TË DURRËSIT**

**Referenca ligjore**

“Tarifat e portit të Durrësit” janë hartuar në përputhje me kërkesat e parashikuara në ligjin nr.9130, datë 8.9.2003 “Për Autoritetin Portual Durrës” kapitulli IV, neni 35 e në vijim.

**1. Përcaktimi i tarifave portuale**

Autoriteti Portual cakton tarifat për:

- anijet, mjetet e transportit dhe personat që përdorin portin;
- ngarkimin e mallrave në anije, shkarkimin e tyre, tregtimin detar brenda kufijve të portit dhe magazinimin në port;
- shërbimet që sigurohen nga Autoriteti Portual ose nga një operator i licencuar, ose një e drejtë e dhënë prej tij në lidhje me portin.

Autoriteti Portual Durrës cakton normën e interesit për pagesat e vonuara.

Në përputhje me nenin 4 të ligjit nr.9130, datë 8.9.2003 “Për Autoritetin Portual”, përkufizimet e termave jepen si më poshtë:

i) “Arkëtimet” janë tarifat e portit dhe të ankorimit në skelë, si dhe arkëtimet e tjera që zbatohen ndaj personave dhe zotëruesve të anijeve, të ngarkesave dhe mjeteve të transportit.

ii) “Pagesa të arkëtuara nga Autoriteti Portual” janë të gjitha pagesat e kryera nga operatorë ose agjentë të ndryshëm të mbledhura nga Autoriteti Portual.

iii) “Tarifa ndaj anijes” është çdo pagesë e kërkuar nga Autoriteti Portual ose nga një operator i licencuar ndaj zotëruesit të anijes ose agjentit të tij.

iv) “Tarifa ndaj mallit” është çdo tarifë e vendosur nga Autoriteti Portual ose nga një operator i licencuar ndaj zotëruesit të mallit ose agjencive të tyre.

v) “Mallrat” janë të gjitha të mirat materiale që përdoren për veprimtarinë tregtare përveç anijes.

**2. Përgjegjësia për pagesat e tarifave**

Tarifat dhe interesat për anijet dhe ngarkesat paguhen nga zotëruesi ose personi që ka në ngarkim anijen ose mallin dhe mblidhen nga Autoriteti Portual ose nga një operator i autorizuar.

Tarifat dhe interesi, të përcaktuara sipas këtij ligji, për mjetet e transportit paguhen nga zotëruesi i mjetit dhe mblidhen nga Autoriteti Portual ose nga një operator i autorizuar.

Në nenin 44 të ligjit nr.9130, datë 8.9.2003 "Për Autoritetin Portual" është parashikuar se:

1. Autoriteti Portual ose një operator i autorizuar ka të drejtën ta mbajë anijen ose të ardhurat nga shitja e saj si garanci për shumën që anija detyrohet, dhe konkretisht kjo shumë ka lidhje me:

a) tarifat dhe interesin që duhet të shlyejë anija për qëndrimin e saj ose për mallrat e ngarkuara në të;

b) dëmtimin e pronës nga anija ose ekuipazhi i saj.

2. Autoriteti Portual ose një operator i autorizuar mund të marrë si garanci mallra për shumën që i duhet të paguajë anija për tarifat dhe interesin.

3. Kur mallrat e mbajtura për garanci janë mallra që prishen, Autoriteti Portual mund t'i shesë me çmim të arsyeshëm dhe të ardhurat kreditohen për të shlyer pagesën që duhet të paguhet për anijen dhe mallrat.

3. Paanësia

Kur cakton tarifat, Autoriteti Portual ose operatori i autorizuar nuk i lejohej të shkelin barazinë e subjekteve përdoruese. Nuk përbën diskriminim nëse bëhen dallime në bazë të vëllimit të mallrave ose të sasisë së të mirave që tregtohen apo mbi baza të tjera, që nga ana tregtare janë të pranueshme për një person të licencuar që ka të drejtën e caktimit të tarifave.

Çdo person i interesuar ka të drejtën e ankimit pranë drejtorit ekzekutiv kur mendon se janë bërë dallime në vendosjen e tarifave portuale.

4. Miratimi i tarifave portuale

Tarifat portuale miratohen nga këshilli drejtues i Autoritetit Portual në përputhje me nenin 15 të ligjit nr.9130, datë 8.9.2003 "Për Autoritetin Portual". Miratimi i tarifave portuale bëhet në fund të çdo viti për vitin e ardhshëm kalendarik.

Tarifat portuale të miratuara nga këshilli drejtues i Autoritetit Portual, propozohen për miratim sipas një udhëzimi të përbashkët të Ministrisë së Punëve Publike dhe Transporteve dhe Ministrisë së Financave.

5. Hyrja në fuqi

Hyrja në fuqi e tarifave portuale përcaktohet në udhëzimin e përbashkët të Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit.

6. Informimi

Tarifat portuale janë publike dhe përdoruesit e portit duhet të jenë gjithmonë të informuar për vendosjen e tarifave të reja apo rishikimin e atyre ekzistuese.

Informimi përfshin publikimin në gazetë ose në Fletoren Zyrtare, si dhe publikimin në faqen e internetit të APD-së.

## KAPITULLI 1

### TARIFAT E PAGUESHME NGA PRONARI APO AGJENTI I ANIJES

#### 1. TARIFAT E PORTIT DHE TË KANALIT

##### 1.1 Përkufizime

##### 1. Interpretim

a) "Tarifa e portit dhe e kanalit" do të thotë një tarifë për një anije e cila përdor kanalën e lundrimit dhe basenin e portit, në Portin e Durrësit.

b) "Pronar" përfshin agjentin, marrësin me qira (Charter) ose zotëruesin e anijes.

c) "Port" do të thotë Porti i Durrësit i organizuar sipas ligjit të Autoritetit Portual.

d) "Traget" do të thotë vetëm anije për pasagjerë dhe automjete.

e) "Certifikata e madhësisë së tonazhit" do të thotë një certifikatë e lëshuar nga një autoritet i matjes i njohur nga Autoriteti Portual i Durrësit, i cili vendos tonazhin e regjistruar bruto (GT) dhe detajet e tjera që kanë të bëjnë me anijen.

##### 2. Aplikime

a) Këto tarifa aplikohen për ato anije të cilat vijnë në ose përdorin portin e Durrësit.

b) Këto tarifa janë të detyrueshme në të gjitha anijet, përfshirë anijet e zotëruara nga Qeveria Shqiptare ose nga qeveria e ndonjë vendi të huaj.

### 3. Tarifat

Tarifat e portit dhe të kanalit duhet të llogariten sipas njësive që janë vendosur në tabelën e mëposhtme:

a) Detyrimet për portin dhe kanalën, të përcaktuara nga këto tarifa, janë të pagueshme menjëherë dhe mbledhen nga Autoriteti Portual Durrës ose përfaqësuesit e tij, nga pronari ose agjenti i anijes në përputhje me termat dhe kushtet e pagesës.

b) Detyrimet që lindin nga aplikimi i tarifës së portit dhe të kanalit janë të pavarura (nuk kanë lidhje) nga detyrimet që lindin nga aplikimi i tarifave të tjera portuale.

#### 4. Përmasat e anijes

a) Nëse janë dy tonazhe bruto ose përmasa të regjistruara në certifikatën e madhësisë së tonazhit, atëherë tonazhi ose përmasa më e madhe do të aplikohet për qëllimin e kësaj tarife.

b) Në qoftë se pronari i anijes e ka të pamundur të dorëzojë një certifikatë të madhësisë së tonazhit, Autoriteti Portual i Durrësit ose përfaqësuesi i tij mund të japë një vlerë të përafërt të tonazhit bruto ose dimensioneve të tjera që kanë të bëjnë me anijen. Tonazhi bruto ose përmasat e tjera të përcaktuara në këtë mënyrë, do të përdoren si tonazh bruto apo përmasa të regjistruara, për efekt të kësaj tarife.

#### 5. Përjashtime

Tarifat e portit dhe të kanalit nuk janë të pagueshme në lidhje me:

a) një luftanije ose ndonjë anije nën komandën e forcave shqiptare, ose një anije e një force vizitore;

b) një anije që i përket qeverisë së një vendi të huaj dhe që nuk është e angazhuar në veprimtari tregtare;

c) një anije e angazhuar vetëm në peshkim dhe të tjera që e tregtojnë peshkun;

d) një anije që hyn në portin e Durrësit për qëllim vendstrehimi në rast të një stuhie apo aksidenti;

e) një anije e përjashtuar nga aplikimi i tarifave, si rezultat i ndonjë marrëveshjeje ndërmjet Shqipërisë dhe një vendi të huaj.

### 1.2 Tarifat e portit dhe të kanalit

1.	Tarifat e portit dhe të kanalit për anije për prekje	Njësia bazë	Tarifa (€)
a)	Për tragete	€/GT	0.15
b)	Për anije të tjera, përfshirë dhe anijet Ro/Ro	€/GT	0.18

## 2. TARIFAT E AKOSTIMIT

### 2.1 Përkufizime

#### 1. Interpretim

a) "Tarifë vendakostimi/kalate" do të thotë tarifë për një anije dhe/ose traget, e cila futet brenda dhe përdor ndonjë kalatë (vendakostim) në portin e Durrësit.

b) "Pronar" përfshin agjentin, marrësin me qira ose zotëruarin e anijes.

c) "Port" do të thotë porti i Durrësit, i organizuar sipas ligjit të Autoritetit Portual.

d) "Certifikata e madhësisë së tonazhit" do të thotë një certifikatë e lëshuar nga një autoritet i matjes, i njohur nga Autoriteti Portual i Durrësit, i cili vendos tonazhin e regjistruar bruto (GT) ose/dhe detajet e tjera që kanë të bëjnë me anijen.

#### 2. Aplikime

a) Këto tarifa aplikohen për ato anije, të cilat vijnë në/ose përdorin portin e Durrësit.

b) Këto tarifa janë të detyrueshme në të gjitha anijet, përfshirë anijet e zotëruara nga Qeveria Shqiptare ose nga qeveria e ndonjë vendi të huaj.

#### 3. Tarifat e kalatës/vendakostimit

a) Tarifat e kalatës/vendakostimit do të llogariten bazuar në tabelën e tarifave të mëposhtme.  
 b) Tarifat e kalatës/vendakostimit të përcaktuara nga këto tarifa janë të pagueshme menjëherë dhe mbliidhen nga Autoriteti Portual i Durrësit ose përfaqësuesit e tij, nga pronari apo agjenti i anijes, në përputhje me termat dhe kushtet e pagesës.

c) Detyrimet që lindin nga aplikimi i tarifës së kalatës/vendakostimit janë të pavarura nga detyrimet që lindin nga aplikimi i tarifave të tjera portuale.

#### 4. Përmasat e anijes

a) Nëse janë dy tonazhe bruto ose përmasa të regjistruara, në certifikatën e madhësisë së tonazhit, tonazhi ose përmasa më e madhe do të aplikohet për qëllimin e kësaj tarife.

b) Në qoftë se pronari i anijes e ka të pamundur të dorëzojë një certifikatë të madhësisë së tonazhit, Autoriteti Portual i Durrësit ose përfaqësuesi i tij mund të japë një vlerë të përafërt të tonazhit bruto ose dimensioneve të tjera që kanë të bëjnë me anijen. Tonazhi bruto ose përmasat e tjera të përcaktuara në këtë mënyrë, do të përdoren si tonazh bruto apo përmasat e regjistruara, për efekt të kësaj tarife.

#### 5. Përjashtime

Tarifat e kalatës/vendakostimit nuk janë të pagueshme në lidhje me:

a) një luftanije ose ndonjë anije nën komandën e forcave shqiptare, ose një anije e një force vizitore;

b) një anije që i përket Qeverisë Shqiptare ose të një vendi të huaj dhe që nuk është e angazhuar në veprimtari tregtare;

c) një anije e angazhuar vetëm në peshkim dhe të tjera që e tregtojnë peshkun;

d) një anije e përjashtuar nga aplikimi i këtyre tarifave, si rezultat i ndonjë marrëveshjeje ndërmjet Shqipërisë dhe një vendi të huaj.

### 2.2 Tarifat e kalatës/vendakostimit

1	Tarifat e kalatës/vendakostimit për anijet, janë të llogaritura bazuar në përmasat e anijes (gjatësia ose gjerësia e përgjithshme sipas akostimit), si dhe kohës së qëndrimit:		Njësia bazë	Tarifa (€)
a	Anije kontejner		€/metër linear të anijes për ditë ose pjesë të saj	4.41
b	Cisterna (kimikate/ lëngje rinfuze)		€/metër linear të anijes për ditë pjesë të saj	3.85
c	Anije kroçerë		€/metër linear të gjatësisë së anijes për ditë ose pjesë të saj	1
d	Tragete, anije Ro/Ro dhe pasagjerësh		€/metër linear të gjatësisë së anijes për ditë ose pjesë të saj	3.50
e	Anije transporti mallrash rifuxho		€/metër linear të gjatësisë së anijes për ditë ose pjesë të saj	2.50
f	Anije transporti mallrash gjenerale		€/metër linear të gjatësisë së anijes për ditë ose pjesë të saj	2.50
2	<b>Tarifat për anijet me flamur shqiptar, të cilat kanë mbaruar proceset e ngarkim-shkarkimit të mallrave.</b> <b>Këto tarifa janë të llogaritura bazuar në kategorinë e madhësisë së anijes GT (tonazh bruto), gjatësinë e anijes dhe kohën e qëndrimit.</b>		Njësia bazë	Tarifa (€)
a	Për anijet deri në dhe përfshirë 500 (GT)		€/ për muaj	113.00

	b	Për anijet mbi 501 deri në dhe përfshirë 4,000 GT	€/ për muaj	226.00
	c	Për anije mbi 4,001 deri në dhe përfshirë 10,000 GT	€/ për muaj	317.00
	d	Për anije mbi 10,000 GT	€/ për muaj	590.00
<p>Përkufizime shtesë  Kjo tarifë nuk aplikohet në rastet kur anija qëndron në kalatë, edhe pse ka marrë urdhrin dhe/ose njoftimin nga dispeçeria qendrore e APD-së, respektivisht Kapitaneria e Portit të Durrësit, për largimin nga kalata, sido që të jetë rasti. Në këto raste do të procedohet sipas rregulloreve dhe për kohën e qëndrimit do të aplikohet tarifa sipas pikës 3.1-1 tarifat e akostimit.  Në rastet e qëndrimit në kalatë pas veprimeve tregtare, vendakostimi/kalata përcaktohet nga Autoriteti Portual i Durrësit.  Vendakostimi nuk duhet të pengojë në asnjë mënyrë anijet që do të kryejnë apo pritet të kryejnë veprimet tregtare dhe/ose operacionet në port.</p>				
<b>3</b>	<b>Tarifat e kalatës/vendakostimit për anijet ose mjetet e lundrim-shërbimit që qëndrojnë në portin e Durrësit, për një kohë të pacaktuar dhe që nuk janë të angazhuara në veprimtari tregtare.</b> <b>Këto tarifa llogariten bazuar në kategorinë e madhësisë së anijes në GT dhe/ose gjatësisë së përgjithshme të saj dhe kohëqëndrimit.</b>		<b>Njësia bazë</b>	<b>Tarifa(€)</b>
	a	Për anije (ose mjete lundrimi) deri në dhe përfshirë 500 GT	€/anije/muaj	113.00
	b	Për anije (ose mjete lundrimi) mbi 500 GT	€/metër linear në ditë ose pjesë të saj	1.27
	c	Skafë turistike	Euro / ditë	10
	d	Biga	Euro/metër linear në ditë	0.8
<b>4</b>	<b>Tarifat e kalatës/vendakostimit, për anije të një organi publik (shtetëror) që qëndrojnë në portin e Durrësit, të cilat nuk janë të angazhuara në veprimtari tregtare.</b> <b>Kjo tarifë llogaritet në bazë të madhësisë së anijes në GT dhe kohës së qëndrimit.</b>		<b>Njësia bazë</b>	<b>Tarifa (€)</b>
	a	Anije	€/ vit	1

## KAPITULLI 2

### TARIFAT E PËRPUNIMIT TË PAGUESHME NGA PRONARI APO AGJENTI I ANIJES APO MALLIT

#### 3. TARIFAT E PËRPUNIMIT TË ANIJEVE ME MALLRA

##### 3.1 Përkufizime

##### 1. Interpretime

- "Tarifë përpunimi" (*handling charges*) do të thotë: një tarifë shërbimi ndaj pronarit të anijes apo mallit ose agjentit të tij, për ngarkim-shkarkimin e anijes në portin e Durrësit.
- "Pronar" përfshin agjentin, marrësin me qira (charterer) ose zotëruesin e anijes.
- "Port" do të thotë porti i Durrësit, i organizuar sipas ligjit të Autoritetit Portual të Durrësit.
- "Madhësia e mallit" do të thotë: një dokument (p.sh. një manifest apo faturë e mallit, listë e mallrave) e lëshuar nga dërguesi i mallrave, pronari, marrësi me qira ose nga agjenti ose agjentët e tyre, të cilët lëshojnë madhësinë e mallit në termat "ton" ose "metër kub".
- Vetëm në rast se është specifikuar ndryshe, në këtë kapitull, termi "përpunim" përfshin, ngarkimin ose shkarkimin e mallrave dhe kontejnerëve dhe imbarkimin apo disimbarkimin e pasagjerëve.

##### 2. Aplikime

- Këto tarifa aplikohen në lidhje me mallrat dhe pasagjerët që mbërrijnë/ikin me anije, të cilat vijnë në ose përdorin portin e Durrësit, për qëllim ngarkimi ose shkarkimi dhe/ose imbarkimi apo disimbarkimi të pasagjerëve dhe Ro-Ro respektivisht.

b) Këto tarifa janë të detyrueshme për të gjitha anijet, përfshirë anijet e zotëruara nga Qeveria Shqiptare ose nga qeveria e ndonjë vendi të huaj.

### 3. Tarifa e përpunimit (*Handling Charges*)

a) Tarifa e përpunimit do të llogaritet siç është vendosur në tabelën e mëposhtme të tarifave.

b) Tarifa e përpunimit e përcaktuar në këtë tarifë është e pagueshme menjëherë dhe mbliidhet nga Autoriteti Portual i Durrësit ose përfaqësuesit e tij (stevedorë ose operatorë terminali të licencuar), në përputhje me termat dhe kushtet e pagesës.

c) Detyrimet që lindin nga aplikimi i tarifës së përpunimit, janë të pavarura nga detyrimet që lindin nga aplikimi i tarifave të tjera portuale.

### 4. Madhësia e mallrave

a) Nëse janë dy tonazhe bruto ose përmasa të regjistruara të ndryshme, p.sh.: ton dhe m<sup>3</sup> në certifikatën e madhësisë së tonazhit, tonazhi ose përmasa më e madhe (p.sh. 3 tonë dhe 8 m<sup>3</sup> do të aplikohet për qëllimin e kësaj tarife).

b) Në qoftë se pronari ose agjenti i anijes e ka të pamundur të dorëzojë një certifikatë të madhësisë/përmasave të mallit (p.sh. manifest, faturë apo listë mallrash) Autoriteti Portual i Durrësit ose përfaqësuesi i tij mund të japë një vlerë të përafërt të madhësisë dhe peshës apo volumit të mallit, që do të konsiderohen përmasat e mallit në ton apo metër kub për qëllim të tarifave.

### 5. Përrjashtime

1. Kostot e përpunimit nuk janë të pagueshme në lidhje me:

a) një luftanije ose ndonjë anije nën komandën e forcave shqiptare, ose një anije e një force vizitore;

b) një anije që i përket qeverisë së një vendi të huaj dhe që nuk është e angazhuar në veprimtari tregtare;

c) një anije e përjashtuar nga pagesa e të tilla tarifave si rezultat i ndonjë marrëveshje ndërmjet Shqipërisë dhe një vendi të huaj.

### 3.2 Përkufizime mbi përpunimin e mallrave rifuxho

1. Këto detyrime janë të vendosura nga Autoriteti Portual dhe/ose stivadori i licencuar përkundrejt pronarit ose agjentit të anijes dhe/ose mallit për ngarkimin ose shkarkimin e anijes.

2. Shërbimet e përfshira në tarife në rast të shkarkimit të anijes:

i) Shkarkimi nën drejtimin/orientimin e komandës së anijes nga pika e qëndrimit në anije deri në kalatë ose në automjet;

ii) Lëvizja e mallrave nga vendi i shkarkimit për në magazinë ose në sheshin e hapur brenda së njëjtës zonë të terminalit në afërsi të kalatës;

iii) Vendosja e mallrave nga magazina ose sheshi hapur në automjetin e dorëzimit.

3. Shërbimet e përfshira në tarifë, në rast ngarkimi të anijes:

i) Shkarkimi në port i mallrave nga automjeti i dërguesit dhe vendosja e mallit në pikën e depozitimit në magazinë ose në sheshe të hapura;

ii) Lëvizja e mallrave brenda së njëjtës zonë (hapësirë të të njëjtit terminal) në port nga pika e depozitimit në magazinë ose në sheshe të hapura, përgjatë kalatës së anijes;

iii) Ngarkim nën drejtimin/orientimin e komandës së anijes së mallrave për anijen brenda hambarit ose mbi kuvertën e anijes përfshirë dhe pozicionimin profesional të mallrave në hambar/kuvertë;

iv) Shkarkimi në port i mallrave nga automjeti i dërguesit dhe ngarkimi i mallrave në të njëjtën zonë/kalatë në port nën drejtimin/orientimin e komandës së anijes të mallrave për anijen brenda hambarit ose mbi kuvertën e anijes, përfshirë dhe pozicionimin profesional të mallrave në hambar/kuvertë.

4. Shërbimet nën këto përkufizime nuk përfshijnë:

i) Sistemimin (*trimming*) në hambarin e anijes së mallrave rifuxho;

ii) Hapjen dhe mbylljen e kapakut të hambarit;

iii) Manipulimin e pajisjeve të anijes;

iv) Numërimin e mallit;

v) Furnizimin e pajisjeve ose të ndonjë materiali të ngjashëm për sigurimin e mallit;

vi) Furnizimin me material dhe konstruktimin në hambarin e anijes me qëllim të ndarjes së mallrave;

vii) Lëvizjen e mallrave ndërmjet zonave të ndryshme të portit (përjashtohet zona e dy kalatave fqinje); të cilat të gjitha ose në veçanti mund të jenë shërbime për të cilat do të aplikohen pagesa më vete.

### 3.3 Tarifat për përpunimin e mallrave të rënda rifuxho

Njësia	Artikulli	Njësia bazë	Çmimi (lekë)
1	Qymyr	lekë/tonë	480
2	Minerale, koncentrate dhe ferrot e tyre (krom, hekur-nikel, bakër, pirit, silic etj.)	lekë/tonë	654
3	Materiale ndërtimi: klinker, materiale inerte, zhavorr, rërë, gurë, gëlqere, rërë xhami, dolomite, barite etj.	lekë/tonë	558
4	Çimento rifuzo me pompë vakuumi	lekë/tonë	526
5	Skrap	lekë/tonë	633
6	Tarifa për sigurinë	lekë/tonë	6
7	Mallra të rrezikshme (sipas IMO/IMDG kode)	lekë/tonë	Shtesë 100% mbi tarifën standarde

### 3.4 Tarifat për përpunimin e mallrave të lehta rifuxho

Njësia	Artikulli	Njësia bazë	Çmimi (lekë)
1	Squfur	lekë/tonë	637
2	Grurë, drithëra, ushqim për kafshët	lekë/tonë	682
3	Plehra kimike	lekë/tonë	575
4	Ngarkesa të rrezikshme (sipas kodit IMO/IMDG)	lekë/tonë	Shtesë 100% mbi tarifën standarde
5	Tarifë për sigurinë	lekë/tonë	6

### 3.5 Tarifat për përpunimin e mallrave të lëngshme

Njësia	Artikulli	Njësia bazë	Çmimi (lekë)
1	Ngarkim/shkarkim të mallrave të lëngshme në kalatë (verë, vaj ushqimor etj.)	lekë/tonë	280
2	Shkarkimi i produkteve të lëngshme në pontil	lekë/tonë	210
3	Shkarkimi i benzinës, benzolit, vajgurit (avionash) në kalatë	lekë/tonë	560
4	Karburant, mazut, bitum në kalatë	lekë/tonë	280
5	Tarifa e sigurisë	lekë/tonë	6
6	Ngarkesa të rrezikshme (sipas kodit IMO/IMDG)	lekë/tonë	Shtesë 100% mbi tarifën standard

### 3.6 Përkufizime mbi përpunimin e mallrave gjenerale

1. Këto detyrime janë të vendosura nga Autoriteti Portual dhe/ose stivadori përkundrejt pronarit të anijes ose agjentit të anijes dhe/ose mallit për ngarkimin ose shkarkimin në/nga anija.

2. Shërbimet e përfshira në tarifë në rast të shkarkimit të anijes:

i) Shkarkim nën drejtimin/orientimin e komandës së anijes nga pika e qëndrimit në anije deri në kalatë ose në automjet;



ii) Lëvizja e mallrave nga pika e shkarkimit për në magazinë ose në sheshin e hapur brenda së njëjtës zonë të terminalit në afërsi të së njëjtës kalatë;

iii) Vendosija e mallrave nga magazina ose sheshi i hapur në automjetin e dorëzimit.

3. Shërbimet e përfshira në tarifë në rast të ngarkimit të anijes:

i) Shkarkimi në port i mallrave nga automjeti i dërguesit dhe vendosja e mallit në pikën e depozitimit në magazinë ose në sheshe të hapura;

ii) Lëvizja e mallrave brenda së njëjtës zonë (hapësirë të të njëjtit terminal dhe kalatë) në port nga pika e depozitimit (magazinë ose në sheshe të hapura) përgjatë anijes;

iii) Ngarkim nën drejtimin/orientimin e komandës së anijes të mallrave për anijen brenda hambarit ose mbi kuvertën e anijes, përfshirë dhe pozicionimin profesional të mallrave në hambar/kuvertë;

iv) Shkarkim në port i mallrave nga automjeti i dërguesit dhe ngarkim i mallrave brenda së njëjtës zonë në port nën drejtimin e komandës së anijes, të mallrave për anijen brenda hambarit ose mbi kuvertën e anijes përfshirë dhe pozicionimin profesional të mallrave në hambar/kuvertë.

4. Shërbimet nën këto përkufizime nuk përfshihen:

i) lidhjen dhe zgjidhjen (*lashing and unlashing*) e mallrave ose kontejnerëve;

ii) hapje-mbyllje të hambarit;

iii) manipulimin e pajisjeve të anijes (*rigging of ship's gear*);

iv) numërimin e mallit ose kontejnerëve;

v) furnizimi i pajisjeve ose i ndonjë materiali të ngjashëm për sigurimin e mallit;

vi) lëvizje ekstra (*shifting*) të mallrave ose kontejnerëve në hambarë, të anijes ose në anije ose në kalatë përgjatë kalatës ose në magazinë apo sheshe;

vii) rikuperimi i paketimit të mallrave të dëmtuara;

viii) mbledhja e mallrave të derdhura ose të shpërndara në vendet e mbledhjes ose ndonjë aktivitet i ngjashëm;

ix) lëvizja apo paraqitja e mallrave në përmbushje të kërkesës së doganës për kontroll doganor;

x) çdo aktivitet tjetër që nuk është përshkruar në pikën 2 ose 3; të cilat të gjitha ose në veçanti mund të jenë shërbime që do të paguhen më vete.

### 3.7 Tarifa për përpunimin e mallrave gjenerale

Nr.	Artikulli	Njësia bazë	Çmimi (lekë)
1	(Normal) Mallra gjenerale, si: fuçi, ballo, binarë, rrumbuj, koli çeliku, hekur, llamarinë, tuba, pllaka zdrukthi, pako, arka të ndryshme etj. deri dhe përfshirë 1500 kg/njësia	lekë/tonë	556
2	(Të rënda) Ngarkesa të rënda, fuçi, ballo, binarë, rrumbuj, koli çeliku, hekur, llamarinë, tuba, pllaka zdrukthi, pako, arka të ndryshme etj. mbi 1500 kg/njësi	lekë/tonë	482
3	(Shumë të rënda) Ngarkesa të rënda dhe me përmasa të mëdha (makineri, pajisje etj.) mbi 5000 kg/njësi	lekë/tonë	subjekt negociimi mbi tarifën
4	(Të lehta) Box, të ndryshme, ngarkesa të lehta dhe gabarite (ambalazhe, goma, depozita uji dhe mallra mbi 3 m <sup>3</sup> /tonë	lekë/tonë	1,155
5	Ngarkesa me thasë	lekë/tonë	650
6	Ngarkesa të paletizuara apo pre-paketuara (big bags, slinga etj.)	lekë/tonë	620
7	Ngarkesa që prishen (paleta, pako, thasë, si p.sh.: fruta të freskëta, banane, perime, mish i ngrirë, vezë etj.)	lekë/tonë	shtesë 25 % mbi tarifën standard
8	Bllaqe mermeri (çfarëdo madhësie)	lekë/tonë	482
9	Ngarkesa të rrezikshme (eksplozivë, lëndë djegëse sipas kodit IMDG)	lekë/tonë	shtesë 100% mbi tarifën standard
10	Tarifë për sigurinë	lekë/tonë	12

### 3.8 Përkufizime të tjera për imbarkimin/disimbarkimin e pasagjerëve

1. Këto tarifa mbliidhen nga Autoriteti Portual i Durrësit ose përfaqësuesi i tij i autorizuar, nga zotëruesi i anijes ose agjenti i tij, për imbarkimin dhe disimbarkimin e pasagjerëve në/nga anija.

2. Shërbimet e përfshira në këtë tarifë janë:

i) Sigurimi i faciliteteve të pasagjerëve dhe shërbimet lidhur me to në portin e Durrësit, duke lejuar hyrje dhe dalje të sigurt në/nga anijet e ankoruara në kalatë;

ii) Ofrimi i sigurisë, faciliteteve dhe shërbimeve të sigurta në portin e Durrësit;

iii) Strehimi dhe facilitetet/objektet e duhura sanitare;

iv) Përpunimi i dokumentacionit përkatës.

3. Shërbimet sipas këtyre përkufizimeve nuk përfshijnë:

i) Çdo shërbim tjetër që nuk është përmendur në pikën 2, i cili mund të faturohet më vete.

4) Për qëllim të kësaj tarife, të rriturit janë persona 12 vjeç e sipër. Me kërkesën e Autoritetit Portual të Durrësit ose përfaqësuesit të tij të autorizuar, pasagjerët do të paraqesin kartën e tyre të identitetit (p.sh. pasaporta) për të lejuar kështu Autoritetin Portual ose përfaqësuesin e tij të autorizuar të verifikojë moshën e tyre.

### 3.9 Tarifat e imbarkimit/disimbarkimit të pasagjerëve me tragete

Njësia	Artikulli	Njësia bazë	Detyrimi (€)
1	Tarifë fikse për çdo mbërritje të tragetit		11.58
2	Imbarkimi i pasagjerëve		
	a Pasagjerë nën 12 vjeç	Person	2
	b Pasagjerë mbi 12 vjeç	Person	4
	c Tarifa e sigurisë për pasagjerë (vetëm për të rritur)	Person	0.5
3	Disimbarkimi i pasagjerëve		
	a Pasagjerë nën 12 vjeç	Person	0
	b Pasagjerë mbi 12 vjeç	Person	0.5
	c Tarifa e sigurisë për pasagjerë (vetëm për të rritur)	Person	0.5

### 3.10 Përkufizime të tjera për përpunimin Roll-on/Roll-off të ngarkesave

1. Këto detyrime janë vënë nga Autoriteti Portual ose Stevedore ndaj zotëruesit ose agjentit të anijes dhe/ose mallit për ngarkimin ose shkarkimin Roll-on/Roll-off të mallrave në/nga anijet, tragetet e pasagjerëve dhe mbajtësit e makinave ose të anijeve të ngjashme për përpunime Roll-on/Roll-off.

2. Në rast të shkarkimit të anijes, shërbimi përfshin:

i) lëvizjen e ngarkesës nën drejtimin e komandës së anijes nga kuverta e anijes deri në vendin e qëndrimit, në terminalin e portit;

ii) dorëzimi i ngarkesës, nga vendi i qëndrimit në terminalin e portit, pronarit të ligjshëm ose përfaqësuesit.

3. Në rast të ngarkimit të anijes, shërbimi përfshin:

i) marrjen e ngarkesës nga transportuesi dhe lëvizjen e saj në drejtim të pikës së qëndrimit në terminalin e portit;

ii) lëvizjen e ngarkesës nga vendi i qëndrimit në rampat e anijes dhe lëvizjet e mëtejshme nën drejtimin e komandës së anijes në hambarin ose kuvertën e anijes.

4. Këto shërbime nuk përfshijnë:

i) lidhjen dhe zgjidhjen dhe sigurimin e ngarkesës në anije;

ii) lidhjen dhe zgjidhjen dhe sigurimin e ngarkesës në trailer, mjet apo shasi, e cila është përgjegjësi e pronarit të mjetit;

iii) rimorkimin dhe/ose lëvizjen e makinave nga mjetet dhe/ose personeli i portit dhe/ose të stevedorit, nëse janë apo jo vetështytëse, në terminalin e portit ose/dhe në hambarin ose në kuvertën e anijes kur ato nuk kanë lidhje direkt me procesin e ngarkim shkarkimit;

iv) ndihma për ndezjen e motorit;

v) spontimi ose aktivitete të ngjashme.

5. Në lidhje me këto tarifa, termi “automjet” përfshin kokë tërheqëse/trailer, makinë/mikrobus ose sisteme makine/karvan.

6. Nëse nuk është shprehur ndryshe, termi “makinë” përfshin dhe autoveturat.

### 3.11 Tarifat e përpunimit të automjeteve<sup>1</sup> dhe makinave (mallra Ro/Ro)

1	Ngarkimi i automjeteve dhe i makinave		Njësia bazë	Detyrimi (€)
	a	Automjet deri në dhe përfshirë 3,5 tonë	Automjet	6
	b	Automjete mbi 3,5 deri në dhe përfshirë 7,5 tonë	Automjet	10
	c	Automjete mbi 7,5 tonë	Automjet	13
2	Shkarkimi i automjeteve dhe makinave		Njësia bazë	Detyrimi (€)
	a	Automjet deri ne dhe përfshirë 3,5 tonë	Automjet	2
	b	Automjete mbi 3,5 deri në dhe përfshirë 7,5 tonë	Automjet	3
	c	Automjete mbi 7,5 tonë	Automjet	4
3	Shërbime për ngarkimin ose shkarkimin e mjeteve apo ngarkesave		Njësia bazë	Detyrimi (€)
	a	Rimorkimin e ngarkesës Ro/Ro me kokat tërheqëse, në dy mënyrat, p.sh. ngarkim ose shkarkim.	Për njësi	20
	b	Dhënia me qira e lefterakut të portit në terminalin e trageteve për përpunimin e mallrave në bord të anijes.	Njësi/orë	24
	c	Pagesa e një tarife sigurie për makinat, furgonët, në të dyja mënyrat, p.sh. ngarkim ose shkarkim.	Për njësi	1
	d	Pagesa e një tarife sigurie për kamionët/trailerat, në të dyja mënyra, p.sh. ngarkimin ose shkarkimin.	Për njësi	2

### 3.12 Përkufizime të tjera për përpunimin e kontejnerëve

1. Këto detyrime janë vënë nga Autoriteti Portual ose stivadori i licencuar ose operatori i terminalit ndaj pronarëve ose agentit të anijes dhe ose mallit për ngarkimin ose shkarkimin e kontejnerëve (ose *flat racks*) në/prej anijeve.

2. Në rastin e shkarkimit të anijeve shërbimet përfshijnë:

i) shkarkimin e kontejnerit nën drejtimin e komandës së anijes nga hambari ose kuverta e anijes në pikën e shkarkimit në kalatën e portit.

ii) lëvizjen e kontejnerit nga pika e shkarkimit për në vendin (slotin) e caktuar në sheshin e portit (terminalit të kalatës së anijes);

iii) dërgimi (ngarkimi) i kontejnerit nga pika e shkarkimit në zonën (slotin) e caktuar të sheshit të portit (terminalit) për në kamionin e marrësit të ngarkesës.

3. Në rastin e ngarkimit të anijes, shërbimet përfshijnë:

i) marrjen e kontejnerit nga automjeti i dërguesit në zonën e marrjes së terminalit dhe lëvizjen e tij në slotin e caktuar të terminalit;

ii) lëvizjen e kontejnerit nga pika e depozitimit (në slotin e caktuar në terminalin e portit) për në pikën e ngarkimit përgjatë anijes;

iii) ngarkimin e kontejnerit në kuvertën e anijes nën drejtimin e komandës së anijes, në hambarin ose kuvertën e anijes në përputhje me planin e komandës së anijes për stivimin e ngarkesës.

4. Këto shërbime në 2 dhe 3 përfshijnë:

i) kontrollin dhe regjistrimin e numrit dhe të vulës së kontejnerit;

<sup>1</sup> Automjet përfshin: kamion, gjysmërimorkiator, gjysmërimorkio, rimorkio, automjete për transport të veçantë, automjete për përdorim të veçantë, automjete bujqësore, automjete teknologjike industriale.

ii) lirimin ose mbërthimin e përshtatësve para ose pas përpunimit për procesin e ngarkim shkarkimit (*ship-to-shore handling*);

iii) përgatitjen e një shkëmbimi të pajisjeve pritëse (EIR)<sup>2</sup>;

iv) regjistrimin e pozicionit të kontejnerit në shesh.

5. Këto shërbime në 2 dhe 3 nuk përfshijnë:

i) lidhjen dhe zgjidhjen e kontejnerit në anije “Lashing and unlashing of containers on the vessel”;

ii) heqjen dhe vendosjen e “teist lock”;

iii) peshimin e kontejnerëve;

iv) ndonjë aktivitet në lidhje me kërkesat e doganës për inspektim;

v) leximin, regjistrimin dhe kontrollimin e temperaturës;

vi) furnizimin me energji elektrike (heqja dhe vendosja e prizës) e kontejnerëve frigoriferike;

vii) mbushjen dhe zbrazen e kontejnerëve, të cilët të gjithë ose në veçanti do të faturohet ekstra.

3.13 Tarifat për përpunimin e kontejnerëve

Njësia	Artikulli		Njësia bazë	Detyrimi (lekë)
1	Ngarkimi dhe shkarkimi i kontejnerëve apo flat raks <sup>3</sup> plot			
	a	Shkarkimi (20 feet)	lekë/box	9,692
	b	Shkarkimi 40 feet, 45 feet)	lekë/box	11,720
	c	Ngarkimi (20 feet)	lekë/box	9,472
	d	Ngarkimi (40 feet, 45 feet)	lekë/box	10,813
2	Ngarkimi dhe shkarkimi i kontejnerëve bosh			
	a	Shkarkimi (20 feet)	lekë/box	6,012
	b	Shkarkimi 40 feet, 45 feet)	lekë/box	7,305
	c	Ngarkimi (20 feet)	lekë/box	5,762
	d	Ngarkimi (40 feet, 45 feet)	lekë/box	6,826
3	Shërbime ekstra për përpunimin e kontejnerëve			
	a	Përkufizime shtesë për shërbime ekstra në përpunimin e kontejnerëve		
		i	Tarifa për shërbimet shtesë mblidhen nga Autoriteti Portual, operatori i licencuar apo operatori i terminalit, nga zotëruesi i anijes apo kontejnerit apo mallit ose agjenti i tij, cilido që të jetë rasti.	
		ii	Për të mënjeluar çdo dyshim, detyrimi për të paguar tarifën ekstra, të cilat përfshihen në pikën 3 dhe 4 janë në përgjegjësi të personit përfaqësues, i cili ka kërkuar kryerjen e këtyre shërbimeve tek Autoriteti Portual ose operatori i licencuar ose operatori terminalit, në formë të shkruar.	
	b	Përpunimi ekstra i kontejnerëve bosh në sheshin e të njëjtit terminal	lekë/box/ kapje	1.307
	c	Përpunimi ekstra i kontejnerëve plot në sheshin e të njëjtit terminal	lekë/box / kapje	2.035
	d	Përpunimi ekstra i ndonjë kontejneri për qëllim peshimi (të gjitha madhësitë) (Shënim. Deklarimi i gabuar për peshën e kontejnerit është shkelje ligjore dhe mund të kërkojë dëmshpërblimin përkatës.)	lekë/box / kapje	854

<sup>2</sup> Një dokument që transferon një kontejner nga një agjenci transporti në një tjetër ose për/nga një terminal.

<sup>3</sup> Flatracks: përbëhet nga një strukturë me kate me një kapacitet të lartë ngarkimi, e përbërë nga një kornizë çeliku dhe nga një kat druri i butë, me dy mure përfunduese, që mund të jenë gjithashtu te palosura ose fikse.

4	Të tjera, shërbime ndihmëse në lidhje me kontejnerët			
	a	Furnizim me energji për kontejnerët me temperaturë të kontrolluar	lekë/box /dite	1,122
	b	Pastrim i kontejnerëve (brenda gjithëpërfshirës me fshesë)		
	i	Deri në dhe përfshirë 20 feet në gjatësi	lekë/box	1,220
	ii	Gjatësia mbi 20 feet	lekë/box	2,440
	c	Lidhja dhe zgjidhja e kontejnerëve në anije për operacion ( <i>Lashing and unlashing</i> ) materialet lidhëse, zgjidhësve duhet të sigurohen nga zotëruesi i anijes	lekë/box	403
	d	Ristivime spostime	lekë/box	3,972
	e	Hapje dhe mbyllje e kapakut të hambarit (cikli i plotë)	lekë/hambar	10,763
	f	Tarifa fikse totale për kamionët e kontejnerëve (çdo madhësi) që hyn ose del nga porti i Durrësit.	lekë/kamion	250
	g	Tarifa për sigurinë portuale bazuar në kërkesat e ISPS-së.		
	i	deri dhe përfshirë 20'	lekë/box	244
	ii	mbi dhe përfshirë 40'	lekë/box	488
5	Peshimi i detyrueshëm			
	a	Autoriteti Portual ose stivadori rezervon të drejtën e pakufizuar të peshojë çdo kontejner për llogari të anijes, transportuesit ose marrësi i ngarkesës, ose të agentit me shpenzime të tyre, nëse pesha e kontejnerit nuk është qartësisht e identifikuar.	lekë/box	E negociuesh me
	b	Për të shmangur dyshimet, deklarimi i gabuar apo mos deklarimi i mallrave të rrezikshme (sipas kodit IMDG) që transportohen në kontejner dhe etiketa korresponduese e kontejnerit ose deklarimi i gabuar ose mosdeklarimi i peshës së kontejnerit është një shkelje e ligjit dhe sjell një dënim të rëndë në përputhje me dëmet.		

#### 3.1.4. Tarifa për raste të veçanta

1. Tarifa për rastet e përpunimit me mjetet e zotëruarit të mallit apo anijes (ose përfaqësuesit e tyre) 50% e tarifës së aplikueshme

Për raste të veçanta kur Autoriteti Portual i Durrësit dhe operatori i autorizuar janë në rrethana që nuk disponojnë apo nuk mund të sigurojnë mjetet që garantojnë përpunimin e anijes (*ship to shore equipment*), mbështetur në kërkesën e përdoruesit, Autoriteti Portual i Durrësit mund të lejojë përpunimin e anijes me mjetet e veta. Tarifa e përpunimit në këto raste do të aplikohet në masën 50% të tarifës së plotë.

2. Tarifa për ditët e diela dhe festa zyrtare 10% shtesë e tarifës përkatëse.

3) Përpunohen pa shtesë tarife anijet si më poshtë:

i) Tragete, Ro-Ro që përpunohen me mjetet e veta

ii) Anijet e karburanteve

iii) Anije që transportojnë kafshë të gjalla ose mallra që prishen shpejt

4. Tarifa për mallrat në hambar bunker 100% shtesë e tarifës përkatëse.

5. Tarifa për lëvizjen e mallrave transit në hambar apo kuvertë. 50% shtesë e tarifës përkatëse.

KAPITULLI 3  
TARIFAT E SHESHIT PRANË KALATËS DHE TË TRANSFERIMIT TË PAGUESHME NGA  
PRITËSI I MALLIT OSE SPEDICIONI

4. TARIFA WHARFAGE DHE TRANSFERIMIT

4.1 Përkufizime

1. Interpretime

a) "fasilitetet publike të portit" do të thotë një kalatë, shesh, sheshe pranë kalatës, mol, dallgëthyes, terminal, magazine ose ndonje ndërtese tjetër;

b) "tarifë transferimi" do të thotë një tarifë në lidhje me transferimin e mallrave nga një anije në një tjetër brenda limiteve të portit;

c) "port" do të thotë porti Durrësit i projektuar sipas ligjit të Autoritetit Portual Durrës;

d) "Wharfage" do të thotë një detyrim i përfituar në përputhje me këtë tarifë në lidhje me të gjithë mallrat të cilat janë:

i) Ngarkuar ose shkarkuar nga një anije në një fasilitet publik të portit;

ii) Shkarkuar nga anija në kalatë (*eharf*) ose e ngarkuar nga kalata në anije, e depozituar nga një vend në kalatë ose e ngarkuar apo shkarkuar nga një automjet në hapësirën publike të portit.

e) "Wharf" do të thotë çdo kalatë, vend depozitimi pranë kalatës e cila është fasilitet publik i portit;

2. Aplikime

a) Kjo tarifë aplikohet në lidhje me të gjitha anijet dhe me mallrat të transportuara nga këto anije, duke përfshirë anijet të poseduara nga Qeveria Shqiptare ose nga qeveria e një vendi të huaj.

3. Detyrimet e përgjithshme

a) Detyrimet Wharfage dhe transfer të përcaktuara nga këto tarifa janë të pagueshme menjëherë dhe do të mbliidhen nga Autoritetit Portual Durrës ose përfaqësuesit të tij i autorizuar, nga spedicionerët ose pritësi i mallit ose agjenti i tyre në përputhje me termat dhe kushtet e pagesës.

b) Detyrimet që lindin nga aplikimi i tarifës së *earfage*, janë të pavaruara nga detyrimet që lindin nga aplikimi i tarifave të tjera portuale.

5. Dokumentacioni

a) Dokumentacioni i plotë, përfshirë *bills of lading* në lidhje me mallrat hyrëse dhe dalëse dhe/ose mallrave në kontejnerë ose trailera apo shasi të një anije, do të sigurohen nga një person në detyrë i anijes për Autoritetin Portual ose përfaqësuesit të tij, kur t'i kërkohet.

b) Autoriteti Portual i Durrësit ose përfaqësuesi i tij rezervon të drejtën të klasifikojë mallrat dhe vendimi i tij në lidhje me këtë do të jetë përfundimtar dhe i detyrueshëm.

6. Tarifa e Wharfage

a) Tarifa Wharfage e pagueshme do të llogaritet bazuar në tabelën e mëposhtme të tarifave.

b) Tarifa Wharfage nuk është e pagueshme në lidhje:

i) Një luftanije ose ndonjë anije nën komandën e forcave shqiptare, ose një anije e një force vizitore;

ii) Shkarkim i peshkut nga anije te peshkimi ose furnizime të ngarkuara në një anije peshkimi akostuar në një fasilitet publik të portit;

iii) Ndonjë mjet motorik kur automjeti është imbarkuar ose disimbarkuar nga një traget;

iv) Mallrat e mbartura nga ndonjë anije e cila është e përjashtuar nga tarifa Wharfage në bazë të termave të një marrëveshje ndërmjet Shqipërisë dhe ndonjë vendi të huaj.

7. Tarifat e transferimit

a) Tarifat e pagueshme të transferimit do të kalkuloohen në masën 1/4 e tarifës Wharfage. Transfer do të nenkuptojë shkarkimin (ardhjen) e një malli nga një anije, qeëndrimin në port (terminal) dhe ngarkimin (largimin) nga porti (terminali) të këtij malli në anije.

b) Tarifat e transferimit nuk janë të pagueshme në lidhje me:

i) Një luftanije ose ndonjë anije nën komandën e forcave shqiptare, ose një anije e një force vizitore;

ii) Një anije që i përket Qeverisë të një vendi të huaj dhe që nuk është e angazhuar në veprimtari tregtare;

- iii) Një anije e angazhuar vetëm në peshkim dhe tjetër që e tregtojnë peshkun;
- iv) Një anije ose mjet lundrues që përdoret për qëllime argëtimi/pushimi, e cila nuk është e angazhuar në veprimtari tregtare.
- v) Një anije e përjashtuar nga pagesa e të tilla tarifave si rezultat i ndonjë marrëveshjeje ndërmjet Shqipërisë dhe një vendi të huaj.

#### 4.2 Tarifat Wharfage

1	Tarifa Wharfage	Njësia bazë	Tarifa (lekë)
	a) Tarifa Wharfage	lekë/ton	13

#### 4.3 Tarifat e transferimit

1	Tarifa transferimit	Njësia bazë	Tarifa (lekë)
	a) Tarifa e transferimit	lekë/ton	¼ Nje e katërta e tarifës së Wharfage

### KAPITULLI 4 MAGAZINIM, QIRAJA DHE TARIFAT E QIRADHËNIES

#### 5. TARIFAT E MAGAZINIMIT TË NGARKESAVE DHE KONTEJNERËVE

##### 5.1 Përkufizime

##### 1. Interpretimi

Në këtë tarifë:

- a) “ditë” nënkupton një periudhë prej 24-orësh konsekuative;
- b) “fasilitet portual” nënkupton Wharf, kalatë, valëpritësin, terminalin, magazinë shesh ose ndërtesa të tjera në port;
- c) “magazinim, depozitim” do të thotë një detyrim financiar i pagueshëm për mallrat që qëndrojnë në fasilitetet portuale në portin e Durrësit;
- d) “shesh depozitimi”, sheshe të destinuara për depozitimin e mallrave të ndryshme;
- e) “shesh në përdorim”, sheshe të destinuara për depozitimin e mallrave të ndryshme për përdorim të përkohshëm jo më shumë se 180 ditë;
- f) “shesh tranzit” sheshe të destinuara për realizimin e proceseve të ngarkim shkarkimit me afat jo më shumë se 25 ditë.

##### 2. Aplikimi

- a) Pagesat e magazinimit që llogariten në përputhje me këtë tarifë, paguhen për ato mallra që qëndrojnë në portin e Durrësit dhe në fasilitetet e tij.
- b) Kjo tarifë aplikohet për të gjitha mallrat që transportohen me anije, përfshirë anijet shqiptare ose të huaja.

##### 3. Pagesat

- a) Pagesat e magazinimit duhet të llogariten mbi bazat e tarifave të përcaktuara më poshtë.
- b) Pagesat e magazinimit të përshkruara në këtë tarifë janë të detyrueshme dhe do të mbliidhen nga Autortieti Portual i Durrësit ose përfaqësuesi i tij i autorizuar nga pronari i mallit apo i kontejnerëve ose përfaqësuesi i tyre sipas termave dhe kushteve të pagesës.
- c) Pagesat e magazinimit të përshkruara në këtë tarifë janë shtesë të pagesave të tjera të përshkruara në tarifat e tjera.

##### 4. Matja e zonës së magazinimit

- a) Autoriteti Portual i Durrësit dhe/ose përfaqësuesit e tij rezervojnë të drejtën, në diskrecionin e tij të vetëm, për të vlerësuar zonën e përdorur për magazinimin e mallrave dhe kjo përlllogaritje do të përdoret për përcaktimin e tarifës.

## 5. Përrjashtime

Tarifat për magazinim nuk paguhen për:

a) shërbimet e lidhura për një luftanije shqiptare nën komandën e Forcave të Armatosura Shqiptare, një anije e një force vizituese ose çdo anije tjetër, e cila është nën komandën e Qeverisë Shqiptare;

b) mallrat e sjella nga një anije, e cila është e përjashtuar nga tarifat sipas marrëveshjes që mund të ekzistojë mes Shqipërisë dhe një vendi të huaj;

c) kontejnerët: 10 ditët e para në të cilat kontejnerët qëndrojnë në terminal apo në fasilitetet e Portit, me përjashtim të rasteve kur ka një marrëveshje paraprake për ruajtjen e këtyre mallrave;

d) mallra: 5 ditët e para konsektive në të cilat mallrat qëndrojnë në terminal fasilitetet portuale apo kalatë, me përjashtim të rasteve kur ka një marrëveshje paraprake për ruajtjen e këtyre mallrave; ose

e) një fasilitet portual për të cilin aplikohet një tarifë e veçantë nga Autoriteti Portual.

### 5.2 Tarifat për magazinimin e kontejnerëve

1	Magazinimi i kontejnerëve (bosh ose plot hyrje ose dalje)	Njësia bazë	Tarifa (lekë)
a	deri në 10 ditë qëndrimi	lekë/TEU/ditë	Pa pagesë
b	nga dita e 11 deri në ditën e 15-të	lekë/TEU/ditë	343
c	nga dita e 16 deri në ditën e 20-të	lekë/TEU/ditë	514
d	mbi ditën e 20-të	lekë /TEU/ditë	684

### 5.3 Tarifat për magazinimin e ngarkesave

1	Tarifa për përdorimin e magazinës	Njësia bazë	Tarifa (lekë)
a	deri në 5 ditë	lekë/m <sup>2</sup> /ditë	Pa pagesë
b	6-10 ditë	lekë/m <sup>2</sup> /ditë	20
c	11-20 ditë	lekë/m <sup>2</sup> /ditë	40% shtesë/ditë
d	21-45 ditë	lekë/m <sup>2</sup> /ditë	60% shtesë/ditë
e	mbi 45 ditë	kontrata afatgjata	
2	<b>Ruajtja afatgjatë në magazinë</b>		
a	1-30 ditë	lekë/m <sup>2</sup> /ditë	12
b	31-60 ditë	lekë/m <sup>2</sup> /ditë	20
c	mbi 61 ditë	lekë/m <sup>2</sup> /ditë	30

## 6. TARIFAT E DHËNIES ME QIRA

### 6.1 Tarifat për dhënien me qira të shesheve

1	Sheshet e përdorimit për mallra rifuxho për një periudhë maksimale deri 180 ditë	Njësia bazë	Tarifa (lekë)
a	deri 45 ditë	lekë /m <sup>2</sup> /ditë	2
b	46 -60 ditë	lekë/m <sup>2</sup> /ditë	4
c	61 - 120 ditë	lekë/m <sup>2</sup> /ditë	6
d	121 - 180 ditë	lekë/m <sup>2</sup> /ditë	10



	Pas kalimit të këtij afati, Autoriteti Portual i Durrësit do të ndjekë hapat respektivë.			
<b>2</b>	<b>Sheshet e përdorimit për mallra gjenerale për një periudhë maksimale deri 180 ditë</b>		<b>Njësia bazë</b>	<b>Tarifa (lekë)</b>
	a	deri 45 ditë	lekë/m <sup>2</sup> /ditë	4
	b	46 - 60 ditë	lekë/m <sup>2</sup> /ditë	8
	c	61 -120 ditë	lekë/m <sup>2</sup> /ditë	12
	d	121 -180 ditë	lekë/m <sup>2</sup> /ditë	20
	Pas kalimit të këtij afati Autoriteti Portual i Durrësit do të ndjekë hapat respektivë.			

#### 6.2 Tarifat për dhënien me qira të shesheve tranzitore

<b>1</b>	<b>Sheshet tranzit për një periudhë maksimale deri 45 ditë</b>		<b>Njësia bazë</b>	<b>Tarifa (lekë)</b>
	Përkufizim: termi dhënie me qira e sheshit tranzitor do të thotë dhënie e sheshit pranë kalatës për periudhën tranzitore në të cilën mallrat do të ngarkohen apo shkarkohen			
	a	deri 10 ditë	lekë/m <sup>2</sup> /ditë	Pa pagesë
	b	11-15 ditë	lekë/m <sup>2</sup> /ditë	7
	c	16-25 ditë	lekë/m <sup>2</sup> /ditë	21
	Pas kalimit të këtij afati Autoriteti Portual Durrës do të ndjekë hapat respektivë.			

#### 6.3 Tarifat e përdorimit të sillosave

<b>1</b>	<b>Tarifa për sillosat e grurit</b>		<b>Njësia bazë</b>	<b>Tarifa (lekë)</b>
	a	deri 48 orë	lekë/silos/ditë	Pa pagesë
	b	3 - 7 ditë	lekë/silos/ditë	8.000
	c	pas kalimit të ditës së shtatë	lekë/silos/ditë	61.000

#### 6.4 Tarifat e dhënies me qira afatgjatë të shesheve

<b>1</b>	<b>Sheshe të hapura depozitimi deri në një vit</b>		<b>Njësia bazë</b>	<b>Tarifa (lekë)</b>
	a	Mallra rifuxho	lekë/m <sup>2</sup> /ditë	2
	b	Mallra gjenerale	lekë/m <sup>2</sup> /ditë	4

#### 6.5 Tarifat për qiratë për ambiente të tjera të portit

<b>1</b>	<b>Tarifa për qiratë e ambiente të tjera të portit</b>		<b>Njësia bazë</b>	<b>Tarifa (lekë)</b>
	a	Ambiente për zyra	lekë/m <sup>2</sup> /muaj	1,000

	b	Shesh për zyrë mobile	lekë/m <sup>2</sup> /ditë	7
	c	Ambiente për operatorët kontraktualë <sup>4</sup>	lekë/m <sup>2</sup> /muaj	150
	d	Sheshe për operatorët kontraktualë	lekë/m <sup>2</sup> /muaj	100

#### 6.6 Tarifat për qiradhënie të mjeteve

1	Tarifa për qiradhënien e mjeteve		Njësia bazë	Tarifa (lekë)
	a	Mjete transporti deri në 10 tonë	lekë/orë	2,550
	b	Forklift deri 3 tonë	lekë/orë	2,501
	c	Forklift deri 12 tonë	lekë/orë	3,843
	d	Forklift deri 32 tonë	lekë/orë	10,736
	e	Vinç mobil me rrota deri 16 tonë	lekë/orë	7,930
	f	Vinç i rëndë i lëvizshëm me goma deri në 45 tonë	lekë/orë	10,736
	g	Fadrome 2 m <sup>3</sup>	lekë/orë	5,380
	h	Reach stacker deri 45 tonë	lekë/orë	11,407
	i	MHC vinç portual mobil	lekë/orë	29,792
	j	Elektro vinç 5 tonë	lekë/orë	6,032
	k	Elektro vinç 10 tonë	lekë/orë	16,787
	l	Elektro vinç 15, 16 dhe 27 tonë	lekë/orë	8,049
	m	Elektro vinç 45 tonë	lekë/orë	31,947

#### 6.7 Tarifat për reklamat

1	Tarifa për reklamat		Njësia bazë	Tarifa (lekë)
	a	Reklamë statike e zakonshme	lekë/m <sup>2</sup> vit	10,370
	b	Reklamë e përbërë e lëvizshme me fletë	lekë/m <sup>2</sup> vit	12,200
	c	Reklamë elektronike (digjitale, lineare)	lekë/m <sup>2</sup> vit	20,740

### KAPITULLI 5

#### 7. TARIFA TË TJERA

##### 7.1 Tarifat për certifikatën e deratizimit

1	Certifikata e përjashtimit të deratizimit të anijes (afati 6 muaj)		Njësia bazë	Tarifa
	a	për anije 0-500 GT	€/certifikatë	50
	b	për anije 501-3000 GT	€/certifikatë	100
	c	për anije mbi 3000 GT	€/certifikatë	150

<sup>4</sup> Operatorë kontraktualë janë operatorët që kanë një kontratë të vlefshme me APD-në për kryerjen e shërbimeve apo punëve. Ambientet dhe sheshet jepen me qira në funksion të realizimit të kontratës.

### 7.2 Tarifa për certifikatën mjekësore të anijes

1	Lëshimi i certifikatës mjekësore për anijen dhe personelin për një periudhë jo më pak se 12 muaj		Njësia bazë	Tarifa
	a	Certifikata mjekësore e anijes (vjetore)	€/anije	20
	b	Certifikata e personelit (vjetore)		
		i për shqiptarë	€/person	5
		ii për të huaj	€/person	10
	c	Certifikata e shërbimit gastronomik kuzhinier (njëvjeçar)	€/person	10
	d	Certifikata për personin e ndihmës së shpejtë (njëvjeçar)	€/person	10

### 7.3 Tarifa e shërbimit për mbrojtjen kundër zjarrit dhe shpëtimit

1	Tarifa e shërbimit për mbrojtjen kundër zjarrit dhe shpëtimit		Njësia bazë	Tarifa
	a	Tarifë për orë në dispozicion	lekë/orë	2,000

### 7.4 Tarifat e parkingut

1	Parkimi i mjeteve brenda portit		Njësia bazë	Tarifa
2	Përkufizime			
	a)	Parkingu i mjeteve në port është i lejuar vetëm në vendet e përcaktuara nga APD-ja.		
	b)	Parkimi jashtë zonave të lejuara përbën shkelje dhe largimi do të kryhet nën koston e pronarit të mjetit apo përdoruesit.		
3	Mjetet që parkohen në zonat e përcaktuara		Njësia bazë	Tarifa
		i Mjetet deri 3,5 tonë	lekë/njësi	500
		ii Mjete 3,5 - 7,5 tonë	lekë/njësi	850
		ii Mjete mbi 7,5 tonë	lekë/njësi	1,000
	c)	Mjetet që parkojnë jashtë zonave operacionale		
		i Mjetet deri 3,5 tonë (në zonat e përcaktuara)	lekë/njësi	100
		ii Mjetet 3,5 -7,5 tonë	lekë/njësi	200
		iii Mjete mbi 7,5 tonë	lekë/njësi	300

### 7.5 Tarifat e personave dhe mjeteve që hyjnë në port

Tarifat e hyrjes për:		Njësia bazë	Tarifa (lekë)
1	Automjete deri dhe përfshirë 3,5 tonë	Automjet/muaj	500
2	Automjete mbi 3,5 tonë deri në dhe përfshirë 7,5 tonë	Automjet/hyrje	150
3	Automjete mbi 7,5 tonë	Automjet/hyrje	250
4	Leje hyrje për person	Person/vit	200
5	Leje hyrje automjeti e përkohshme	Automjet	200

## 7.6 Komisioni për mbledhjen e të ardhurave

1	Komisioni për mbledhjen e të ardhurave	1% e vlerës së të ardhurave të arkëtuara
	Për të ardhurat e mbledhura nga operatorët portualë dhe agjencitë e autorizuara nga Autoriteti Portual i Durrësit për llogari të APD-së do të aplikohet komisioni i mbledhjes së të ardhurave nga tarifat. Komisioni aplikohet në masën 1% të të ardhurave të arkëtuara.	

### URDHËR

Nr.1763, datë 28.2.2011

### MBI MIRATIMIN E DY PROJEKTUDHËZIMEVE TË PROPOZUARA NGA KËSHILLI DREJTUES I AGJENCISË SË SIGURIMIT TË DEPOZITAVE

Në bazë dhe për zbatim të nenit 53 pika 4 të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të nenit 9, pika 3 të Statutit të Bankës së Shqipërisë, miratuar me vendimin nr.100, datë 19.12.2000 të Këshillit Mbikëqyrës, të ndryshuar; të nenit 2 shkronja “c”, nenit 11 pika 2 shkronja “ë” dhe nenit 32, të ligjit nr.8873, datë 29.3.2002 “Për sigurimin e depozitave”, të ndryshuar, nenit 108 pika 1 shkronjat “b” dhe “d” të Kodit të Procedurave Administrative, dhe pasi u njoha me vendimet e Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave nr.prot.234, datë 1.6.2009 dhe nr.prot.244, datë 25.6.2009,

#### URDHËROJ:

1. Miratimin e udhëzimit “Mbi marrëdhëniet e Agjencisë së Sigurimit të Depozitave me bankat e siguruar” sipas tekstit të aneksit nr.1 bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
2. Miratimin e udhëzimit “Mbi pranimin e bankave në skemën e sigurimit të depozitave dhe certifikimin e tyre” sipas tekstit të aneksit nr.2 bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
3. Ngarkohen Agjencia e Sigurimit të Depozitave dhe bankat, dhe degët e bankave të huaja për zbatimin e këtij urdhri.
4. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integritet Europian dhe Komunikimit, për publikimin e udhëzimeve të miratuara me këtë urdhër në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.
5. Udhëzimet e miratuara me këtë urdhër hyjnë në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas botimit të tyre në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.
6. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

GUVERNATORI  
**Ardian Fullani**

#### ANEKSI NR. 1

#### UDHËZIM

#### MBI MARRËDHËNIET E AGJENCISË SË SIGURIMIT TË DEPOZITAVE ME BANKAT E SIGURUARA

#### Neni 1 Objkti

Objkti i këtij udhëzimi është përcaktimi i marrëdhënieve të Agjencisë me bankat e siguruar për realizimin e detyrimeve ligjore për sigurimin e depozitave.

Neni 2  
**Subjekti**

Subjekte të këtij udhëzimi janë bankat dhe degët e bankave të huaja që ushtrojnë veprimtari bankare në Republikën e Shqipërisë.

Neni 3  
**Baza ligjore**

Ky udhëzim del në bazë dhe për zbatim të:

- a) ligjit nr.8873, datë 29.3.2002 “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar, dhe;
- b) ligjit nr.9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 4  
**Përcaktimet**

Termat e përdorur në këtë udhëzim do të kenë të njëjtin kuptim me përcaktimet e nenit 2 të ligjit nr.8873, datë 29.3.2002 “Për sigurimin e depozitave”, të ndryshuar, si dhe ligjit nenit 4 të ligjit nr.9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 5  
**Primi vjetor**

1. Çdo bankë e siguar i paguan Agjencisë primin vjetor të sigurimit të depozitës, që është 0,5 për qind e mesatares aritmetike të shumës së depozitave të siguruara që janë regjistruar në bankë, në fund të çdo dite pune të tremujorit të fundit të vitit të shkuar.

2. Primi i parë vjetor i bankës së porsalicencuar, llogaritet mbi bazën e depozitave të regjistruara përgjatë 12 muajve të parë të veprimtarisë së kësaj banke. Vlerësimi i depozitave bankare të regjistruara për bankën e porsalicencuar bëhet nga Autoriteti Mbikëqyrës dhe Agjencia e Sigurimit të Depozitave.

3. Primi i parë vjetor i bankës së porsalicencuar për periudhën e mbetur nga momenti i licencimit nga Autoriteti Mbikëqyrës vlerësohet proporcionalisht në përputhje me nenin 24, pika 7 të ligjit nr.8873, datë 29.3.2002 “Për sigurimin e depozitave”, të ndryshuar.

4. Përlllogaritja e primit vjetor të sigurimit të depozitës bëhet sipas të dhënave në aneksin nr.1 të këtij udhëzimi.

5. Banka e siguar, në fillim të tremujorit të katërt, por jo më vonë se data 15 tetor, dërgon në Agjenci parashikimin e primit vjetor që do t'i paguajë asaj për vitin e ardhshëm.

6. Pagesa e primit vjetor bëhet në lekë në llogarinë e Agjencisë në Autoritetin Mbikëqyrës, me katër këste, ku çdo këst paguhet respektivisht brenda 15 ditëve nga mbyllja e çdo tremujori.

7. Për qëllim të llogaritjes së primit vjetor depozitat në valutë konvertohen në lekë sipas kursit zyrtar të këmbimit të përcaktuar nga Autoriteti Mbikëqyrës në ditën e vlerësimit.

8. Bankat e siguruara krijojnë sisteme elektronike për ruajtjen dhe përpunimin e të dhënave për efekt të llogaritjes të primit vjetor sipas aneksit nr.1 të këtij udhëzimi.

9. Bankat e siguruara duhet të vënë në dispozicion të Agjencisë informacionin në formë shkresore dhe/ose elektronike sipas pikës 8 të këtij neni gjatë procesit të verifikimit dhe sa herë që i kërkohet nga Agjencia.

10. Çdo vit, banka e siguar bashkë me pagesën e kështit të parë të primit vjetor plotëson dhe paraqet pranë Agjencisë, deklaratën e llogaritjes së primit duke u mbështetur në nenin 24, pika 5 të ligjit nr.8873, datë 29.3.2002 “Për sigurimin e depozitave”, të ndryshuar, në çdo rast jo më vonë se data 15 prill, sipas modelit në aneksin nr.2 të këtij udhëzimi.

11. Pagesën e kësteve të tjera, banka e siguar e bën sipas modelit të njoftimit në aneksin nr.3 të këtij udhëzimi, që do t'u dërgohet atyre nga Agjencia në përputhje me deklaratën e dorëzuar prej tyre në Agjenci sipas pikës 10 të këtij neni, brenda datës 15 të muajt të fundit të çdo tremujori.

12. Banka e siguar rikthen në Agjenci kopjen e njoftimit të nënshkruar nga personat e autorizuar brenda datës 30 të muajt të fundit të çdo tremujori.

13. Primi vjetor për sigurimin e depozitave nuk rimburohet, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në ligjin nr.8873, datë 29.3.2002 “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar, si dhe në këtë udhëzim.

14. Bankat e siguruara detyrohen të paguajnë primin vjetor:

a) të deklaruar, para afatit ligjor sipas përcaktimeve të nenit 24 pika 8, si dhe nenit 20 pika 1, shkronja “a” të ligjit nr.8873, datë 29.3.2002 “Për sigurimin e depozitave”, të ndryshuar;

b) të rritur, deri në nivelin dhe sipas përcaktimeve të nenit 24 pika 3 dhe nenit 20/1 pika 1, shkronja “b” të ligjit nr.8873, datë 29.3.2002 “Për sigurimin e depozitave”, të ndryshuar.

c) të ulur në përputhje me përcaktimet e nenit 24 pika 4 të ligjit nr.8873, datë 29.3.2002 “Për sigurimin e depozitave”, të ndryshuar.

15. Shuma e primit vjetor të paguar para afatit ligjor nga bankat e siguruara, në përputhje me pikën 14, shkronja “a” të këtij neni, i zbritet ose rimburohet bankave sipas përcaktimeve të nenit 20/1 pika 2 e ligjit nr.8873, datë 29.3.2002 “Për sigurimin e depozitave”, të ndryshuar.

## Neni 6 Verifikimet

1. Agjencia sigurohet për saktësinë dhe integritetin e informacioneve dhe dokumentacioneve edhe nëpërmjet procesit të verifikimit të kryer drejtpërsëdrejti në bankat e siguruara të paktën një herë në vit.

2. Agjencia e Sigurimit të Depozitave në mënyrë të veçantë verifikon në bankat e siguruara saktësinë e metodologjisë për llogaritjen e primit vjetor për sigurimin e depozitave.

3. Bankat e siguruara mbajnë informacione për depozitat dhe depozituesit në përputhje me kërkesat e Agjencisë sipas aneksit nr.4 të këtij udhëzimi. Nga të dhënat për depozituesit në këtë tabelë banka është e detyruar të ketë të paktën të dhënat që vijojnë (emri, mbiemri, atësia, gjinia, numrin e pasaportës, datëlindjen, adresën, degën e bankës). Agjencia verifikon në mënyrë të veçantë saktësinë e mbajtjes së këtyre të dhënave.

4. Sistemi informatik i bankës së siguruar duhet të mundësojë në çdo kohë plotësimin e kërkesave të përcaktuara në aneksin nr.5 të këtij udhëzimi.

5. Bankat e siguruara informojnë depozituesit për skemën e sigurimit të depozitave dhe Agjencia verifikon saktësinë e këtij informacioni.

6. Agjencia sipas rastit kërkon nga Autoriteti Mbikëqyrës përfshirjen e përfaqësuesve të saj në ekzaminimet që Autoriteti Mbikëqyrës kryen në bankën e siguruar.

7. Bankat e siguruara mbajnë përgjegjësi ligjore për vërtetësinë, saktësinë dhe plotësinë e informacionit të dërguar pranë Agjencisë.

8. Agjencia në përfundim të procesit të verifikimit dërgon në bankën e siguruar raportin e procesit të verifikimit. Në këtë raport, Agjencia informon bankën për gjetjet e konstatuara gjatë procesit të verifikimit dhe kërkon përmirësimin e tyre sipas kërkesave të këtij udhëzimi. Bankat e siguruara detyrohen të përmirësojnë metodologjinë e llogaritjes së primit, sistemin e ruajtjes së të dhënave për depozitë dhe depozitues, mënyrën e informimit të depozituesve, sipas kërkesave të këtij udhëzimi dhe brenda afateve të përcaktuara në raportet e verifikimit.

## Neni 7 Informimi

1. Banka e siguruar, është e detyruar të informojë menjëherë Agjencinë dhe të dërgojë dokumentacionin lidhur me ndryshimet në veprimtarinë e saj, veçanërisht lidhur me:

a) aksionarët;

b) statutin e bankës së siguruar;

c) administratorët;

d) shtrirjen e rrjetit të degëve të bankave që operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

e) numrin e degëve dhe agjencive që operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

2. Informacioni i dërguar në Agjenci për çështjet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni shoqërohet me dokumentacionin përkatës, i cili përmban vendimin e organit përkatës të bankës, si dhe në rast se ndryshimi është subjekt i miratimit paraprak nga Autoriteti Mbikëqyrës dhe me një kopje të

vendimit të këtij të fundit. Banka e siguruar dërgon në Agjenci listën e personave të autorizuar, të cilët kanë të drejtë të dërgojnë këtë informacion, duke përfshirë emrin e personit të kontaktit të bankës për çështje, që lidhen me sigurimin e depozitave. Për këtë qëllim banka njofton menjëherë Agjencinë për çdo ndryshim në këtë listë.

3. Agjencia mund të sigurohet për saktësinë e informacionit dhe dokumentacionit të dhënë nëpërmjet verifikimeve të kryera drejtpërsëdrejti në bankën e siguruar.

4. Banka e siguruar dërgon në Agjenci të dhënat sipas aneksit 6 të këtij udhëzimi, jo më vonë se 10 ditë kalendarike pas përfundimit të çdo muaji.

5. Banka e siguruar dhe/ose personat e autorizuar prej saj mbajnë përgjegjësi për vërtetësinë dhe saktësinë e informacionit dhe dokumentacionit të dërguar në Agjenci sipas këtij neni.

#### Neni 8

### **Transparenca me publikun**

1. Bankat e siguruara informojnë depozituesit mbi sigurimin e depozitave në përputhje me nenin 30 të ligjit nr.8873, datë 29.3.2002 “Për sigurimin e depozitave”, të ndryshuar.

2. Bankat e siguruara, në veçanti, vendosin certifikatën për sigurimin e depozitave në një vend të dukshëm në mjediset e të gjitha degëve dhe agjencive të bankës së siguruar, që operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

#### Neni 9

### **Masat ndëshkimore**

1. Në rast të mospërbushjes të detyrimeve të këtij udhëzimi, Agjencia e Sigurimit të Depozitave, si dhe Autoriteti Mbikëqyrës zbatojnë dispozitat e parashikuara në nenin 26 të ligjit nr.8873, datë 29.3.2002 “Për sigurimin e depozitave”, të ndryshuar.

2. Banka e siguruar është e detyruar pas marrjes së këtyre masave të informojë Autoritetin Mbikëqyrës dhe Agjencinë për mënyrën dhe afatin e zbatimit të tyre.

#### Neni 10

### **Dispozita përfundimtare**

Anekset bashkëlidhur janë pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

#### Neni 11

### **Hyrja në fuqi**

Ky udhëzim hyn në fuqi me miratimin e tij nga Autoriteti Mbikëqyrës.

## **ANEKSI 1**

### **MËNYRA E PËRLLOGARITJES SË PRIMIT VJETOR NGA BANKAT E SIGURUARA**

Baza ligjore mbi të cilën mbështetet detyrimi i Agjencisë për sigurimin e depozitave bankare, si dhe detyrimi i bankave për të paguar primin vjetor të sigurimit të depozitave, është ligji nr.8873, datë 29.3.2002 “Për sigurimin e depozitave”, ndryshuar me ligjin nr.10 106, datë 30.3.2009 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8873, datë 29.3.2002 “Për sigurimin e depozitave”, neni 3 pika 1 dhe neni 24.

Bankat në llogaritjen e primit të sigurimit bazohet në depozitat e individëve që janë subjekt i skemës së sigurimit të depozitave në përputhje me nenet 4, 5 të ligjit nr.8873, datë 29.3.2002 “Për sigurimin e depozitave”, të ndryshuar.

Primi vjetor i sigurimit të depozitës, është i barabartë me 0,5 për qind të mesatares aritmetike të shumës së depozitave të siguruara që janë regjistruar në bankë, në fund të çdo dite pune të tremujorit të fundit të vitit të shkuar.

Mënyra e llogaritjes së primit të sigurimit të depozitave që banka duhet të respektojë në përputhje me kërkesat e ligjit nr.8873, datë 29.3.2002 “Për sigurimin e depozitave”, të ndryshuar, është sqaruar më poshtë:

Shënojmë me “D” masën e mesatares aritmetike të depozitave të siguruara, të regjistruara në fund të çdo ditë pune të tremujorit të fundit të vitit të shkuar, për BANKËN ANONIM, sipas përcaktimit të dhënë në nenin 4 të ligjit nr.8873, datë 29.3.2002 “Për sigurimin e depozitave”, të ndryshuar.

Depozitat e siguruara të çdo individ, mbi të cilat përcaktohet shuma “D”, vlerësohen duke marrë në konsideratë situatat e mundshme sipas rasteve të mëposhtme:

Rasti i parë: Depozituesi ka vetëm një depozitë individuale në lekë:

a) Në qoftë se kjo depozitë është më e vogël se 2 500 000 (dy milionë e pesëqind mijë) lekë, ajo sigurohet e plotë (përfshihet interesi ditor i llogaritur në ditën e vlerësimit të primit);

b) Në qoftë se është më e madhe se 2 500 000 lekë, sigurohet pjesa deri në nivelin 2 500 000 lekë.

Rasti i dytë: Depozituesi ka disa depozita individuale, të cilat janë në lekë dhe në monedhë të huaj. Depozitat në monedhë të huaj konvertohen në lekë sipas kursit zyrtar të Autoritetit Mbikëqyrës në ditën e vlerësimit, dhe më pas të gjitha depozitat agregohen. Shuma e gjetur nga agregimi, krahasohet me nivelin 2 500 000 lekë dhe sigurohet pjesa e depozitës deri në nivelin e mbulimit.

Rasti i tretë: Depozituesi ka disa depozita individuale dhe një ose më shumë depozita të përbashkëta. Në këtë rast agregimi përfshin të gjitha depozitat individuale, duke shtuar edhe pjesën korresponduese të depozitës të përbashkët, e cila ndahet në pjesë të barabarta midis titullarëve të saj, përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe në kushtet e vendosjes së depozitës.

Për konkretizim, në rast se një depozitues ka një depozitë të përbashkët me një të afërmin e tij, një depozitë individuale dhe një tjetër të përbashkët me dy persona të tjerë ose më shumë, atëherë ky depozitues është disponues i gjysmës së shumës së depozitës që ka me të afërmin e tij, i depozitës individuale dhe i një të tretës ose më pak proporcionalisht, se depozitës së përbashkët me personat e tjerë, ato agregohen dhe sigurohet pjesa deri në 2 500 000 (dy milionë e pesëqind mijë) lekë.

Rasti i katërt: Depozituesi ka depozita të vendosura si garanci për një person të tretë. Në këtë rast e drejta për sigurim të depozitës i njihet titullarit të depozitës, dhe kjo depozitë është e siguar në momentin e lirimimit nga detyrimi i garancisë. Në rast se titullari nuk arrin të lirohet nga detyrimi i garancisë, shuma e siguar përfitohet nga personi i tretë, në favor të të cilit është vendosur garancia.

Rasti i pestë: Depozituesi ka depozitë të vendosur, me kusht ose me afat në përfitim të një personi të tretë, të drejtat për sigurim të depozitës i njihen këtij të fundit, pas plotësimit të afatit ose kushtit përkatës. Në të kundërt, e drejta për sigurim i takon titullarit të depozitës. Në rastin e depozitës së vendosur në përfitim ose si garanci të më shumë se një personi të tretë, zbatohen rregullat e parashikuara për depozitat e përbashkëta.

Rasti i gjashtë: Depozituesi që ka statusin e kreditorit dhe debitorit në lidhje me bankën, për agregimin e depozitave të tij merret në konsideratë shuma nga bashkimi i cilësive të kreditorit dhe debitorit në një të vetëm. Kjo shumë krahasohet me 2 500 000 (dy milionë e pesëqind mijë) lekë, dhe sigurohet pjesa deri në këtë nivel mbulimi.

Shënojmë me 1, 2, 3, .....63, ditët e punës gjatë tremujorit të fundit të vitit të shkuar (sipas kalendarit të dërguar nga Banka e Shqipërisë, ku përcaktohen ditët e punës).

Mesatarja aritmetike e shumës së depozitave të siguruara që janë regjistruar në bankë në fund të çdo dite pune të tremujorit të fundit të vitit të shkuar është:

$$\frac{D1 + D2 + D3 + D4 + \dots + D63}{63}$$

Numrin e ditëve të punës të tremujorit të fundit të vitit paraardhës (63 ditë) = A 000 lekë

Shuma e primit vjetor të sigurimit të depozitave, që do të paguajë BANKA ANONIM është:

$$A \text{ 000 lekë} * 0.5 / 100^5 = B \text{ 000 lekë}$$

Kjo shumë do të paguhet me katër këste të barabarta, jo më vonë se 15 ditë kalendarike pas përfundimit të çdo tremujori. Pra, pagesa do të bëhet deri në datat:

- 15 prill,
- 15 korrik,

<sup>5</sup> Sipas vendimit të Këshillit Drejtues të ASD-së me akt nënligjor të Autoritetit Mbikëqyrës (norma e primit do të jetë jo më pak se 0.1 % dhe jo më shumë se 0.7 %.



- 15 tetor,
- 15 janar.

Shkelja e këtyre afateve do të jetë subjekt i dënimeve në zbatim të ligjit nr.8873, datë 29.3.2002 “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar, neni 26.

Banka për efekt të transparencës të verifikimit të mënyrës së llogaritjes së primit të sigurimit, duhet të evidentojë në mënyrë të dukshme të gjitha hallkat e ekzekutimit të programit për llogaritjen e primit, nga momenti fillestar i të dhënave analitike për depozitat dhe kreditë, deri në shumën përfundimtare të primit të sigurimit të depozitave.

## ANEKSI 2

Banka .....

### DEKLARATA E PRIMIT TË SIGURIMIT TË DEPOZITAVE QË BANKA E SIGURUAR PAGUAN PRANË “AGJENCIA E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE PËR VITIN” .....

Në zbatim të nenit 24 pika 5 të ligjit nr.8873, datë 29.3.2002 "Për sigurimin e depozitave", ndryshuar me ligjin nr.10 106, datë 30.3.2009 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8873, datë 29.3.2002 “Për sigurimin e depozitave””, të ndryshuar, më poshtë ju paraqesim deklaratën e llogaritjes së primit për vitin...

#### Përshkrimi

Mesatarja aritmetike e shumës së depozitave të siguruara, të regjistruara në fund të çdo dite pune të tremujorit të fundit të vitit të shkuar.

1. Shuma në lekë.....
2. Norma e primit në lekë.....
3. Primi vjetor.....
4. Kësti për tremujor.....

Në llogaritjen e mesatares aritmetike të shumës së depozitave të siguruara janë marrë në konsideratë:

1. Teprica kreditore e llogarisë depozitë e të gjitha llojeve, dhe interesi i llogaritur, regjistruar në fund të çdo dite pune në tremujorin e fundit të vitit të shkuar.
2. Agregimi i depozitave të siguruara të çdo depozituesi, të vendosura në disa llogari.
3. Konvertimi në lekë i të gjitha llogarive depozitë në monedhë të huaj, duke aplikuar kursin zyrtar të Bankës së Shqipërisë për çdo ditë pune, në ditën e vlerësimit.

Përfshihen nga këto përlllogaritje, sipas nenit 5 të ligjit nr.8873, datë 29.3.2002 “Për sigurimin e depozitave”, të ndryshuar:

- a) pjesa e depozitës mbi 2 500 000 (dy milionë e pesëqind mijë) lekë ose shuma e barasvlershme me të (kundërvleftën), në monedhë të huaj;
- b) depozitat e çdo shoqërie tregtare, personi fizik ose personi tjetër juridik;
- c) depozitat e drejtorit, të administratorëve, të debitorëve të bankës së siguruar ose të çdo depozituesi tjetër, me të njëjtin status në personat juridikë të lidhur me bankën në fjalë;
- d) depozitat e çdo personi që zotëron, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të drejtën e pronësisë të një aksionari në masën 5 për qind (pesë për qind) ose më shumë në kapitalin e bankës së siguruar ose të aksioneve me të drejtë vote të lidhur me bankën në fjalë;
- e) depozitat e personave, të cilët kryejnë detyrën e auditimit dhe certifikimin e llogarive kontabël në bankat e siguruara, si dhe depozituesit me të njëjtin status në shoqëritë e tjera të të njëjtit grup;
- f) depozitat e çdo depozituesi të bankës së siguruar, që gëzon më shumë se 20 për qind (njëzet për qind) interes preferencial, të ndryshëm nga interesi i zbatuar sipas kushteve të punës për të gjithë depozituesit e tjerë të kësaj banke;
- g) depozitat e çdo personi në bankën e siguruar, që përdor llogarinë depozitë për veprimtari kriminale;
- h) depozitat jonominative, përfshirë depozitat në letrat me vlerë të prurësit;

- i) depozitat në degën e bankës jashtë Shqipërisë;  
j) depozitat e vendosura në bankën e siguruar gjatë dhe pas ditës së ndërhyrjes në këtë bankë.

### ANEKSI 3

Njoftimi nr.

NIPTI-i i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave K 314 19 037 P

Emri i Bankës

Adresa

NJOFTIM

Nga

Agjencia e Sigurimit të Depozitave  
Rruga e Elbasanit, pranë ambasadës amerikane  
Tiranë, Shqipëri

Data

Referenca e deklaratës së

Nr. \_\_\_\_\_ Datë \_\_\_\_\_

Tel. 2362989

Kësti nr. \_\_\_\_\_ për vitin \_\_\_\_\_

Shuma (në lekë) \_\_\_\_\_

Zbritje/shtesa \*\* \_\_\_\_\_

Totali \_\_\_\_\_

\*\*Koment për zbritje/shtesa \_\_\_\_\_

Nr. llogarisë: 2411001 L, pranë Bankës së Shqipërisë

\* Deklarata e primit

Depozitat e siguruar ..... Norma e primit (%) .....

Primi vjetor (në lekë) ..... Kësti..... (në lekë)

Pagesa e kështit të radhës bëhet brenda datës 15 të muajit pasardhës të çdo tremujori.

Nënshkrimi i ASD

Nënshkrimi i autorizuar i bankës së siguruar

\*\*\* Ky njoftim lëshohet në dy kopje origjinale, njëra prej të cilave kthehet në agjenci e firmosur nga personat e autorizuar të bankës së siguruar, brenda datës 30 të çdo fund tremujori.

**ANEKSI 4**  
**REGJISTRI I DEPOZITUESVE DHE DEPOZITAVE**

Të dhëna për çdo depozitues që është subjekt i skemës së sigurimit të depozitave

Nr.	kodi	Emër, mbiemër	Atësia	Gjinia	Nr. pasaportës	Data e lëshimit	Afati i skadencës	Datëlindja	Adresa	Tel.	e-mail	Dega e bankës

Të dhënat për depozitat\* e çdo depozituesi që është subjekt i skemës së sigurimit të depozitave

Nr. i llogarisë	Shuma + interesat	Lloji i monedhës	Titullari i depozitës	Nr. i titullarëve + % në depozitë	Kredi/detyrime të tjera**	Shuma neto (depozita -kredi dhe detyrime të tjera)		

\* Përfshihen të gjitha llojet e produktit depozitë.

\* Përfshihen të gjitha llojet e kredive apo detyrimeve të tjera që depozituesi ka ndaj bankës së siguruar.

**ANEKSI 5**  
**PARAMETRAT TEKNIKË QË DUHET TË PLOTËSOJË, DHE RAPORTET QË DUHET TË GJENEROJË SISTEMI INFORMATIK I BANKËS**

Sistemi informatik i bankës duhet të mundësojë në çdo kohë, vendosjen e parametrave të mëposhtëm:

- Shuma e mbulimit;
- Kursi zyrtar i këmbimit në ditën e vlerësimit;
- Kodi i identifikimit të depozituesit;
- Të gjitha kategoritë e produktit depozitë për depozituesin subjekt i skemës;
- Të gjitha kategoritë e produktit kredi për depozituesin subjekt të skemës;
- Detyrime të tjera të depozituesit ndaj të tretëve;
- Kushti përjashtues për interesin preferencial, i cili është 20 % më shumë se interesi i zbatuar sipas kushteve të punës për të gjithë depozituesit e tjerë.

Gjithashtu, sistemi informatik duhet të mundësojë në çdo kohë gjenerimin e raporteve të mëposhtme:

- Listën e plotë të depozituesve të bankës që janë subjekt i skemës të sigurimit të depozitave, së bashku me shumën përkatëse të depozitave të agreguara;
- Listën e depozituesve të bankës që nuk janë subjekt i skemës të sigurimit të depozitave;
- Listën e depozitave që nuk përfshihen në skemën e sigurimit të depozitave;
- Konvertimin në lekë të të gjitha depozitave në monedhë të huaj me kursin zyrtar të këmbimit i përcaktuar nga Autoriteti Mbikëqyrës në ditën e vlerësimit kërkuar nga ASD;
- Evidentimi i depozitave me interes preferencial, i cili është 20 % më shumë se interesi i zbatuar sipas kushteve të punës për të gjithë depozituesit e tjerë;
- Listën e depozituesve që kanë një detyrim kundrejt bankës, me shumën përkatëse të kredisë që ata kanë;
- Listën e depozituesve që janë subjekt i skemës së sigurimit të depozitave pas bashkimit të cilësive të debitorit dhe kreditorit në një të vetëm, e shoqëruar me shumën përkatëse të depozitave të tyre krahasuar me nivelin e mbulimit;
- Raporte të ndryshme statistikore në varësi të situatave të ndryshme që do të paraqiten.

ANEKSI 6  
KLASIFIKIMI I DEPOZITAVE SIPAS NIVELEVE

Tabela 1

KLASIFIKIMI I DEPOZITAVE TË AGREGUARA TË INDIVIDËVE QË PËRFITOJNË NGA  
SKEMA E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE

Muaji.....  
000/lekë

Struktura e depozitave të individëve	Totali	
	Nr.	Shuma
Deri 2 500 000		
2 500 001 - 3 500 000		
3 500 001 - 4 500 000		
4 500 001 - 5 500 000		
5 500 001 - 6 500 000		
mbi 6 500 000		
<b>Total</b>		

Shënim. Informacioni të përmbajë përmbledhjen e të gjitha depozitave në çdo lloj monedhe, të konvertuara në lekë sipas kursit zyrtar të Bankës së Shqipërisë për ditën e fundit të muajit.

Tabela 2

KLASIFIKIMI I DEPOZITAVE TË INDIVIDËVE TË AGREGUARA  
PAS BASHKIMIT TË CILËSIVE TË DEBITORIT DHE KREDITORIT  
NË NJË TË VETËM

Muaji ....  
000/lekë

Struktura e depozitave të individëve	Totali	
	Nr.	Shuma
Deri 2 500 000		
2 500 001-3 500 000		
3 500 001-4 500 000		
4 500 001-5 500 000		
5 500 001-6 500 000		
mbi 6 500 000		
<b>Total</b>		

Shënim. Informacioni të përmbajë përmbledhjen e të gjitha depozitave në çdo lloj monedhe të konvertuara në lekë sipas kursit fiks të Bankës së Shqipërisë për ditën e fundit të muajit.

KLASIFIKIMI I DEPOZITAVE TË INDIVIDËVE QË PËRFITOJNË  
NGA SKEMA E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE

Muaji.....  
000/lekë

Lekë

Struktura e depozitave të individëve	Totali	
	Nr.	Shuma
Deri 2 500 000		
2 500 001-3 500 000		
3 500 001-4 500 000		
4 500 001-5 500 000		
5 500 001-6 500 000		
mbi 6 500 000		
<b>Total</b>		

000/lekë

Për secilën valutë

Struktura e depozitave të individëve	Totali	
	Nr.	Shuma
Deri 2 500 000		
2 500 001-3 500 000		
3 500 001-4 500 000		
4 500 001-5 500 000		
5 500 001-6 500 000		
mbi 6 500 000		
<b>Total</b>		

000/lekë

Totali i depozitave të klientëve (klasa II sipas SRU)	Shuma
Shënim. Për konvertimin e valutave të përdoret kursi fiks i Bankës së Shqipërisë i ditës së fundit të muajit.	

## TË DHËNA PËR PRODUKTIN DEPOZITË PËR INDIVIDË SIPAS KATEGORIVE NË SHUMË DHE NË NUMËR\*

Monedha	Llogari rrjedhëse (pagat)		Llogari rrjedhëse (transferta)		Llogari rrjedhëse (të tjera)		Llogari depozite pa afat		Llogari depozite me afat		Certifikatë depozite	
	Numri	Shuma	Numri	Shuma	Numri	Shuma	Numri	Shuma	Numri	Shuma	Numri	Shuma
ALL												
AUD												
CAD												
CHF												
DKK												
EUR												
GBP												
USD												
Të tjera												

\* Duhet të përfshihen të gjitha kategoritë e produktit depozitë, emërtimet e të cilave ndryshojnë në varësi të bankës suaj.

\*\* Grupi i llogarive të pagave për punonjësit e subjekteve klientë të bankës suaj të jepet i veçuar.

\*\*\* Të konvertuara në lekë.

## ANEKSI NR.2

### UDHËZIM

#### MBI PRANIMIN E BANKAVE NË SKEMËN E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE DHE CERTIFIKIMIN E TYRE

##### KREU I

##### DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

###### Neni 1

###### **Objekti**

1.1 Objekti i këtij udhëzimi është përcaktimi i kushteve, afateve dhe dokumentacionit:

- a) për përgatitjen e kushteve teknike dhe organizative për plotësimin e kushtit për sigurimin e depozitave;
- b) për pranimin në skemën e sigurimit të depozitave, certifikimin e bankës dhe degës së bankës së huaj që ushtron veprimtarinë bankare në Republikën e Shqipërisë, si dhe certifikimin e bankës dhe degës së bankës së huaj në rast riorganizimi juridik;
- c) për përfundimin e sigurimit të depozitave në bankën dhe degën e bankës së huaj që ushtron veprimtarinë bankare në Republikën e Shqipërisë.

###### Neni 2

###### **Subjekti**

Subjekte të këtij udhëzimi janë personat fizikë dhe/ose juridikë të cilët kanë marrë miratimin paraprak dhe/ose janë licencuar nga Autoriteti Mbikëqyrës, për të ushtruar veprimtari bankare në Republikën e Shqipërisë.

###### Neni 3

###### **Baza ligjore**

3.1 Ky udhëzim del në bazë dhe për zbatim të:

- a) ligjit nr.8873, datë 29.3.2002 “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar.
- b) ligjit nr.9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”.

###### Neni 4

###### **Përcaktimet**

4.1 Termat e përdorur në këtë udhëzim do të kenë të njëjtin kuptim me:

- a) përcaktimet e nenit 2 të ligjit nr.8873, datë 29.3.2002 “Për sigurimin e depozitave”, të ndryshuar;
- b) përkufizimet e nenit 4 të ligjit nr.9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”; dhe
- c) përkufizimet e nenit 4 të rregullores “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së bankave dhe degëve të bankave të huaja në Republikën e Shqipërisë”, miratuar me vendimin nr.14, datë 11.3.2009 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

## KREU II PRANIMI DHE CERTIFIKIMI I BANKËS NË SKEMËN E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE

### Neni 5

#### **Pranimi i bankës në skemën e sigurimit të depozitave**

5.1 Subjektet, me marrjen e miratimit paraprak për licencë nga Autoriteti Mbikëqyrës, paraqesin menjëherë pranë agjencisë kërkesën për t'u njohur me kushtet teknike dhe organizative për plotësimin e kushtit për sigurimin e depozitave, si dhe një kopje të noterizuar të vendimit të këshillit drejtues të subjektit për përcaktimin e personit të kontaktit sipas aneksit 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

5.2 Agjencia dhe subjekti që paraqet kërkesën sipas pikës 5.1 të këtij neni, brenda 12 muajve, bashkëpunojnë për përgatitjen e kushteve teknike dhe organizative për plotësimin e kushtit të sigurimit të depozitave.

5.3 Subjektet që kanë aplikuar për t'u pranuar në skemën e sigurimit të depozitave, përpara pranimi në këtë të fundit, plotësojnë kushtet teknike për krijimin e sistemeve elektronike për ruajtjen dhe përpunimin e të dhënave për efekt të llogaritjes së primit vjetor, si dhe të kompensimit të depozitave, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në anekset 2, 3 dhe 4, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

5.4 Subjektet, që kanë aplikuar për t'u pranuar në skemën e sigurimit të depozitave, përpara pranimi në këtë të fundit, plotësojnë kushtet organizative, sipas aneksit 5 bashkëlidhur.

5.5 Subjektet që pas marrjes së miratimit paraprak, kërkojnë me shkrim dhënien e licencës nga Autoriteti Mbikëqyrës, paraqesin menjëherë pranë agjencisë kërkesën zyrtare për pranimin në skemën e sigurimit të depozitave, shoqëruar me dokumentacionin e nevojshëm sipas aneksit 6 bashkëlidhur këtij udhëzimi.

5.6 Agjencia shqyrton kërkesën, dokumentacionin e paraqitur, si dhe mund të verifikojë në vend plotësimin e kushteve teknike dhe organizative për pranimin në skemën e sigurimit të depozitave, në përputhje me kërkesat e këtij udhëzimi.

5.7 Agjencia njofton subjektin që ka aplikuar për pranimin në skemën e sigurimit të depozitave, nëse dokumentacioni i paraqitur prej tij nuk është i plotë dhe/ose nuk përmbush kërkesat e përcaktuara në këtë udhëzim, si dhe përcakton afatin për plotësimin e tyre.

5.8 Agjencia lëshon një vërtetim për Autoritetin Mbikëqyrës për plotësimin e kushtit të sigurimit të depozitave, nëse vlerëson se subjekti përmbush kërkesat e përcaktuara në këtë udhëzim, lidhur me dokumentacionin dhe kushtet teknike të nevojshme.

### Neni 6

#### **Certifikimi**

6.1 Këshilli Drejtues i Agjencisë miraton kërkesën për sigurimin e depozitave të bankës së re jo më vonë se tri ditë pune nga data e marrjes së njoftimit me shkrim nga Autoriteti Mbikëqyrës për dhënien e licencës bankare.

6.2 Agjencia, brenda tre ditëve pune nga miratimi i kërkesës, njofton bankën për pranimin në skemën e sigurimit të depozitave dhe tërheqjen e certifikatës për sigurimin e depozitave.

6.3 Banka e sapolicencuar, anëtare e skemës së sigurimit të depozitave, njofton me shkrim agjencinë për datën e fillimit të veprimtarisë së saj.

6.4 Banka e siguruar publikon certifikatën për sigurimin e depozitave në një vend të dukshëm në mjediset e të gjitha degëve dhe agjencive të saj që operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

### Neni 7

#### **Certifikimi në rastin e riorganizimit juridik të bankës dhe në rastin e ndryshimit të emrit**

7.1 Banka e siguruar, që ka marrë miratimin paraprak nga Autoriteti Mbikëqyrës për riorganizimin juridik të saj, paraqet menjëherë kërkesën pranë agjencisë për pajisje me certifikatë të re të sigurimit të depozitave.

7.2 Në rastet e ndryshimit të emrit, banka ka detyrimin të paraqesë pranë agjencisë njoftimin lidhur me këtë ndryshim, si dhe kërkesën për t'u pajisur me certifikatën e re që reflekton ndryshimin e emrit. Kërkesa shoqërohet me vendimin e Autoritetit Mbikëqyrës për dhënien e miratimit paraprak për



ndryshimin e emrit të bankës, një kopje të ekstraktit lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit ku të jetë regjistruar ndryshimi përkatës i emrit të bankës dhe një kopje të statutit pas ndryshimit të emrit.

7.3 Në rastet e riorganizimit “bashkim me përthithje”, banka përthithëse ka detyrimin të paraqesë pranë agjencisë njoftimin lidhur me riorganizimin, si dhe kërkesën për t’u pajisur me certifikatë të re nëse do të ketë ndryshim emri. Kërkesa shoqërohet me vendimin e Autoritetit Mbikqyrës për dhënien e miratimit paraprak për riorganizimin e bankës nëpërmjet bashkimit me përthithje, një kopje të ekstraktit lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit mbi ndryshimin përkatës të bankës, një kopje të statutit, si dhe kur është rasti strukturën e re të aksionerëve dhe ndryshimet e administratorëve që rrjedhin nga riorganizimi.

7.4 Në rastet e riorganizimit “bashkim me krijim”, bankat ekzistuese kanë detyrimin të paraqesin pranë agjencisë njoftimin lidhur me riorganizimin, si dhe kërkesën për t’u pajisur me certifikatën e re për sigurimin e depozitave. Kërkesa shoqërohet me vendimin e Autoritetit Mbikëqyrës për dhënien e miratimit paraprak për riorganizimin e bankës nëpërmjet bashkimit me krijim, një kopje të ekstraktit lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit mbi ndryshimin përkatës të bankës, një kopje të statutit, si dhe kur është rasti strukturën e re të aksionerëve dhe ndryshimet e administratorëve që rrjedhin nga riorganizimi.

7.5 Në rastet e riorganizimit “ndarje me krijim”, banka që ndahet ka detyrimin të paraqesë pranë agjencisë njoftimin lidhur me riorganizimin, si dhe kërkesën për t’u pajisur me certifikatën e re për sigurimin e depozitave. Kërkesa shoqërohet me vendimin e Autoritetit Mbikëqyrës për dhënien e miratimit paraprak për riorganizimin e bankës nëpërmjet ndarjes me krijim, një kopje të ekstraktit lëshuara nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit mbi ndryshimin përkatës të bankës, një kopje të statutit, si dhe kur është rasti strukturën e re të aksionarëve dhe ndryshimet e administratorëve që rrjedhin nga riorganizimi.

7.6 Në rastet e riorganizimit me “ndarje me përthithje”, banka që ndahet ka detyrimin të paraqesë pranë agjencisë njoftimin lidhur me riorganizimin. Kërkesa shoqërohet me vendimin e Autoritetit Mbikëqyrës për dhënien e miratimit paraprak, një kopje të ekstraktit lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit mbi ndryshimin përkatës, një kopje të statutit, si dhe kur është rasti strukturën e re të aksionarëve dhe ndryshimet e administratorëve që rrjedhin nga riorganizimi.

7.7 Dokumentacioni i kërkuar sipas pikave 7.2, 7.3, 7.4, 7.5, dhe 7.6 të këtij udhëzimi, duhet të jetë në gjuhën shqipe, në original ose në kopje të noterizuar. Ky dokumentacion dërgohet pranë agjencisë me postë të regjistruar.

7.8 Agjencia, nëse e gjykon të nevojshme, mund të kërkojë nga banka që paraqet kërkesën për ndryshim të certifikatës për sigurimin e depozitave, informacione shtesë, të tjera nga ato të parashikuara në këtë dispozitë.

7.9 Format i kërkesës për pajisje me certifikatë të re në rastet e riorganizimit juridik të bankës sipas këtij neni, përcaktohet në aneksin 7 bashkëlidhur këtij udhëzimi.

7.10 Këshilli Drejtues i Agjencisë miraton ndryshimin në certifikatën e sigurimit të depozitave brenda tri ditëve pune nga marrja e kërkesës së bankës për t’u pajisur me certifikatën e re.

7.11 Agjencia njofton bankën për tërheqjen e certifikatës së sigurimit të depozitave, jo më vonë se dy ditë pune nga marrja e vendimit të Këshillit Drejtues për ndryshimin në certifikatën për sigurimin e depozitave.

7.12 Në rastet kur riorganizimi juridik i bankës çon në krijimin e të paktën një banke të re, kjo e fundit do t’i nënshtrohet të gjitha rregullave për pranimin dhe certifikimin në skemën e sigurimit të depozitave sipas dispozitave të ligjit “Për sigurimin e depozitave”.

7.13 Në çdo rast, agjencia pajis bankën me certifikatën e re të sigurimit të depozitave vetëm pasi kjo e fundit ka dorëzuar pranë saj certifikatën e mëparshme të sigurimit të depozitave.

## Neni 8

### Njoftime të tjera

8.1 Banka e siguruar njofton me shkrim agjencinë brenda 30 ditëve kalendarike, në rastet kur merr miratim paraprak nga Autoriteti Mbikëqyrës për ndryshime të tjera nga ato që parashikohen në nenin 7 të këtij udhëzimi, në veçanti lidhur me:

- hapjen e degëve dhe agjencive të reja brenda territorit të Republikës së Shqipërisë;

- ndryshimin e selisë (zyrave të drejtorisë qendrore) dhe/ose vendit/adresës së ushtrimit të aktivitetit të degëve ose agjencive të saj;
- ndryshimet në strukturën e aksionarëve;
- emërimin e një ose disa administratorëve.

8.2 Njoftimi i bankës, në rastet e përmendura në pikën 8.1 të këtij udhëzimi, shoqërohet me kopje të vendimit të Autoritetit Mbikëqyrës për miratimin paraprak të ndryshimeve përkatëse.

8.3 Agjencia, pas njoftimit të marrë për ndryshimin e vendit/adresës së ushtrimit të aktivitetit të degëve apo agjencive, mund të verifikojë në vend plotësimin e kushteve teknike dhe organizative të përcaktuara në këtë udhëzim.

### KREU III PROCESI I SIGURIMIT TË DEPOZITAVE

#### Neni 9 **Kontributi fillestar**

9.1 Çdo bankë, kërkesa e së cilës pranohet nga agjencia, sipas nenit 23, pika 7 të ligjit nr.8873, datë 29.3.2002 “Për sigurimin e depozitave”, të ndryshuar, i paguan kontribut fillestar agjencisë, jo më vonë se 30 ditë kalendarike nga dhënia e licencës bankare nga Autoriteti Mbikëqyrës.

9.2 Banka, kërkesa e së cilës është pranuar nga Agjencia, derdh në llogarinë e Agjencisë së Sigurimit të Depozitave pranë Autoritetit Mbikëqyrës, kontributin fillestar që është 0,5 për qind të kapitalit të nënshkruar të bankës.

9.3 Kontributi fillestar paguhet njëherësh në lekë në llogarinë e Agjencisë pranë Autoritetit Mbikëqyrës. Banka paraqet pranë Agjencisë konfirmimin e pagesës së kontributit fillestar.

9.4 Këshilli Drejtues i Agjencisë mund të vendosë përjashtimin nga detyrimi për pagesën e kontributit fillestar për bankat e reja, të cilat krijohen duke marrë përsipër depozitat dhe detyrimet e një banke të siguruar ekzistuese.

#### Neni 10 **Përfundimi dhe përjashtimi**

10.1 Sigurimi i depozitës në bankën e siguruar përfundohet nga Agjencia, kur Autoriteti Mbikëqyrës njofton me shkrim:

- a) ndërhyrjen në bankën e siguruar;
- b) revokimin e licencës bankare të bankës së siguruar.

10.2 Sigurimi i depozitës, në rastet e riorganizimit juridik të bankës së siguruar, përfundon për secilën bankë pjesëmarrëse në këtë proces, tre muaj prej datës që Agjencia njoftohet me shkrim nga Autoriteti Mbikëqyrës për përfundimin e procesit të transformimit.

10.3 Në rastin e likuidimit vullnetar të bankës së siguruar, depozitat mbeten të siguruara, në përputhje me dispozitat e ligjit “Për sigurimin e depozitave”, të ndryshuar, deri në përfundim të këtij procesi.

10.4 Në çdo rast, Agjencia kompenson depozitat vetëm pas njoftimit, me shkrim, nga Autoriteti Mbikëqyrës për ndërhyrjen në bankën e siguruar.

10.5 Agjencia, jo më vonë se 24 orë nga vendimi për përfundimin e sigurimit të depozitës së bankës, njofton me shkrim Autoritetin Mbikëqyrës dhe bankën e siguruar. Njoftimi i Agjencisë botohet në Fletoren Zyrtare dhe të paktën në një gazetë kombëtare me tirazhin më të madh.

10.6 Agjencia e përjashton bankën e siguruar nga skema e sigurimit të depozitave kur plotësohet pika 10.1.b e këtij neni.

10.7 Agjencia njofton Autoritetin Mbikëqyrës në mënyrë të plotë dhe të detajuar për përjashtimin e bankës së siguruar nga skema, brenda 24 orëve nga vendimi i Këshillit Drejtues.

10.8 Banka, e cila njoftohet nga Agjencia për përfundimin e sigurimit të depozitave sipas këtij neni, dorëzon menjëherë në Agjenci certifikatën e sigurimit të depozitave.

KREU IV  
DISPOZITAT E FUNDIT

Neni 11  
**Dënime**

Në rast të mospërbushjes të detyrimeve të këtij udhëzimi, Agjencia e Sigurimit të Depozitave, si dhe Autoriteti Mbikëqyrës zbatojnë dispozitat e parashikuara në nenin 26 të ligjit nr. 8873, datë 29.3.2002 “Për sigurimin e depozitave”, të ndryshuar.

Neni 12  
**Dispozita tranzitore**

Ky udhëzim do të zbatohet vetëm për procedurat e nisura pas hyrjes në fuqi të tij. Si datë e fillimit të procedurave të parashikuara në këtë udhëzim do të konsiderohet data e paraqitjes së plotë të kërkesës apo njoftimit dhe dokumentacionit përkatës në Agjenci.

Neni 13  
**Dispozita përfundimtare**

Anekset bashkëlidhur janë pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

ANEKSI 1

**KËRKESE**

PËR NJOHJEN ME KUSHTET TEKNIKE DHE ORGANIZATIVE PËR PLOTËSIMIN E KUSHTIT  
PËR SIGURIMIN E DEPOZITAVE NGA BANKAT DHE DEGËT E BANKAVE TË HUAJA QË  
KANË MARRË MIRATIMIN PARAPRAK PËR LICENCË NGA AUTORITETI MBIKËQYRËS PËR  
TË KRYER VEPRIMTARI BANKARE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Me anë të kësaj kërkesë i drejtohem Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për të na njohur me kushtet teknike dhe organizative për plotësimin e kushtit për sigurimin e depozitave në zbatim të ligjit nr.8873, datë 29.3.2002 “Për Sigurimin e Depozitave” të ndryshuar, si dhe ligjit nr.9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”.

Shprehemi të gatshëm për të plotësuar çdo kërkesë të Agjencisë lidhur me kushtet teknike dhe organizative në funksion të përmbushjes së detyrimeve të përcaktuara në ligjin nr.8873, datë 29.3.2002 “Për sigurimin e depozitave”, të ndryshuar, si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Bashkëlidhur, ju paraqesim kopje të noterizuar të vendimit të Bankës së Shqipërisë për dhënien e miratimit paraprak për licencë bankare.

Emri i bankës ose i degës së bankës së huaj:  
Banka/dega

Adresa \_\_\_\_\_

Nënshkrimi i personit të kontaktit

Formulari nr.1 (vazhdim i aneksit nr.1)

**VENDIMI**  
**I KËSHILLIT DREJTUES PËR CAKTIMIN E PERSONIT TË KONTAKTIT**

Këshilli Drejtues i propozuar vërteton që informacioni i paraqitur në këtë kërkesë është i vërtetë dhe i plotë. Për më tepër, këshilli drejtues i propozuar emëron dhe përcakton si person kontakti:

\_\_\_\_\_

(Emri) (atësia) (mbiemri)

Adresa:

\_\_\_\_\_

(Rruga, numri) (qyteti) (shteti)

\_\_\_\_\_ (Numri i telefonit)

\_\_\_\_\_ (Numri i faksit/teleksit)

\_\_\_\_\_ (Adresa e postës elektronike)

Personi i kontaktit është i autorizuar të përfaqësojë bankën e propozuar dhe të paraqitet të nënshkruajë para Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, përveç rasteve kur Agjencia e Sigurimit të Depozitave, do të kërkojë veprime personale nga anëtarët e këshillit drejtues. Personi i kontaktit është i autorizuar të bëjë gjithçka të nevojshme, në mënyrë sa më të plotë dhe të përmbushë të gjitha synimet dhe qëllimet siç do të mund t'i bënte vetë i nënshkruari nëse do të paraqiste dhe do të merrte personalisht gjithë korrespondencën dhe dokumentet nga Agjencia e Sigurimit të Depozitave.

Personi i kontaktit i emëruar mund të ndryshohet me rezolutë të pranuar nga pjesa më e madhe e nënshkruesve, rezolutë e cila do të vërtetohet në Agjencinë e Sigurimit të Depozitave nga nënshkruesit që votojnë për të njëjtën gjë.

Datë \_\_\_\_\_,

(Emri, mbiemri) i anëtarëve të këshillit (nënshkrimi)

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

Shënim. Ky formular vërtetohet nga noteri.

2

ANEKSI 2 \*\*

REGJISTRI I DEPOZITUESVE DHE DEPOZITAVE

Të dhëna për çdo depozitues që është subjekt i skemës së sigurimit të depozitave:

Nr.	Kodi	Emër, mbiemër	Atësia	Gjinia	Nr.i pasaportës	Data e lëshimit	Afati i skadencës	Datëlindja	Adresa	Tel.	e-mail	Dega e bankës

Të dhënat për depozitat\* e çdo depozituesi që është subjekt i skemës së sigurimit të depozitave:

Nr. i llogarisë	Shuma + interesat	Lloji i monedhës	Pronësia mbi depozitën	Nr. i pronarëve + % në depozitë	Kredi/detyrime të tjera**	Shuma neto (depozita –kredi dhe detyrime të tjera)

\* përfshihen të gjitha llojet e produktit depozitë.

\*\* përfshihen të gjitha llojet e kredive apo detyrimeve të tjera që depozituesi ka ndaj bankës së siguruar.

\*\*\* Banka duhet të krijojë sisteme elektronike të mbajtjes së këtyre të dhënave, si dhe evidentimi i këtij informacioni duhet të mundësohet për t'u siguruar në mënyrë elektronike, si dhe dokumentare.

### ANEKSI 3

#### MËNYRA E PËRLLOGARITJES SË PRIMIT VJETOR NGA BANKAT E SIGURUARA\*

Baza ligjore mbi të cilën mbështetet detyrimi i Agjencisë për sigurimin e depozitave bankare, si dhe detyrimi i bankave për të paguar primin vjetor të sigurimit të depozitave, është ligji nr.8873, datë 29.3.2002 “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar, neni 3 pika 1 dhe neni 24.

Bankat në llogaritjen e primit të sigurimit do të kenë në konsideratë depozitat e individëve që janë subjekt i skemës të sigurimit të depozitave në përputhje me nenet 4, 5 të ligjit nr.8873 datë 29.3.2002 “Për sigurimin e depozitave”, të ndryshuar.

Primi vjetor i sigurimit të depozitës, është i barabartë me 0,5 për qind të mesatares aritmetike të shumës së depozitave të siguruara që janë regjistruar në bankë, në fund të çdo dite pune të tremujorit të fundit të vitit të shkuar.

Mënyra e llogaritjes së primit të sigurimit të depozitave që banka duhet të respektojë në përputhje me kërkesat e ligjit, është sqaruar më poshtë:

Shënojmë me “D” masën e mesatares aritmetike të depozitave të siguruara, të regjistruara në fund të çdo dite pune të tremujorit të fundit të vitit shkuar, për BANKËN ANONIM, sipas përcaktimit të dhënë në nenin 4 të ligjit nr.8873 “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar.

Depozitat e siguruara të çdo individ, mbi të cilat përcaktohet shuma “D”, vlerësohen duke marrë në konsideratë situatat e mundshme sipas rasteve të mëposhtëme:

Rasti i parë: Depozituesi ka vetëm një depozitë individuale në lekë. Në qoftë se kjo depozitë është më e vogël, se 2 500 000 lekë, ajo sigurohet e plotë (përfshihet interesi ditor i llogaritur në ditën e vlerësimit të primit), në qoftë se është më e madhe se 2 500 000 lekë, sigurohet pjesa deri në nivelin 2 500 000 lekë.

Rasti i dytë: Depozituesi ka disa depozita individuale, të cilat janë në lekë dhe në monedhë të huaj. Depozitat në monedhë të huaj konvertohen në lekë sipas kursit fiks të Autoritetit Mbikëqyrës në ditën e vlerësimit, dhe më pas të gjitha depozitat agregohen. Shuma e gjetur nga agregimi, krahasohet me nivelin 2 500 000 lekë dhe sigurohet pjesa e depozitës deri në nivelin e mbulimit.

Rasti i tretë: Depozituesi ka disa depozita individuale dhe një ose më shumë depozita të përbashkëta. Në këtë rast agregimi përfshin të gjitha depozitat individuale duke shtuar edhe pjesën korresponduese të depozitës të përbashkët, e cila ndahet në pjesë të barabarta midis pronarëve të saj, përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe në kushtet e vendosjes së depozitës.

Për konkretizim, në rast se një depozitues ka një depozitë të përbashkët me një të afërmin e tij, një depozitë individuale dhe një tjetër të përbashkët me dy persona të tjerë ose më shumë, atëherë ky depozitues është disponues i gjysmës së shumës së depozitës që ka me të afërmin e tij, i depozitës individuale dhe i një të tretës ose më pak proporcionalisht, së depozitës së përbashkët me personat e tjerë, ato agregohen dhe sigurohet pjesa deri në 2 500 000 lekë.

Rasti i katërt: Depozituesi ka depozita të vendosura si garanci për një person të tretë. Në këtë rast pronësia i njihet titullarit të depozitës dhe kjo depozitë është e siguruar në momentin e lirimimit nga detyrimi i garancisë. Në rast se titullari nuk arrin të lirohet nga detyrimi i garancisë, shuma e siguruar përfitohet nga personi i tretë, në favor të të cilit është vendosur garancia.

Rasti i pestë: Depozituesi ka depozitë të vendosur me kusht ose me afat në përfitim të një personi të tretë, të drejtat për sigurim të depozitës i njihen këtij të fundit, pas plotësimit të afatit ose kushtit përkatës. Në të kundërt, e drejta për sigurim i takon titullarit të depozitës. Në rastin e depozitës së vendosur në përfitim ose si garanci të më shumë se një personi të tretë, zbatohen rregullat e parashikuara për depozitat e përbashkëta.

Rasti i gjashtë: Depozituesi që ka statusin e kreditorit dhe të debitorit në lidhje me bankën, për agregimin e depozitave të tij merret në konsideratë shuma nga bashkimi i cilësive të kreditorit dhe debitorit në një të vetëm. Kjo shumë krahasohet me 2 500 000 lekë dhe sigurohet pjesa deri në këtë nivel mbulimi.

Shënojmë me 1, 2, 3, .....63, ditët e punës gjatë tremujorit të fundit të vitit të shkuar (sipas kalendarit të dërguar nga Banka e Shqipërisë, ku përcaktohen ditët e punës).

Mesatarja aritmetike e shumës së depozitave të siguruara që janë regjistruar në bankë në fund të çdo dite pune të tremujorit të fundit të vitit të shkuar është:

$$\frac{D1 + D2 + D3 + D4 + \dots + D63}{63}$$

Numrin e ditëve të punës të tremujorit të fundit të vitit paraardhës (63 ditë) = A 000 lekë

Shuma e primit vjetor të sigurimit të depozitave, që do të paguajë BANKA ANONIM është:

$$A \text{ 000 lekë} \cdot 0.5 / 100^6 = B \text{ 000 lekë}$$

Kjo shumë do të paguhet me katër këste të barabarta, jo më vonë se 15 ditë kalendarike pas përfundimit të çdo tremujori. Pra, pagesa do të bëhet deri në datat:

- 15 prill,
- 15 korrik,
- 15 tetor,
- 15 janar.

Shkelja e këtyre afateve do të jetë subjekt i penaliteteve në zbatim të ligjit nr.8873, datë 29.3.2002 “Për sigurimin e depozitave”, (të ndryshuar), neni 26 “Përjashtimi dhe dënimi”.

\* Banka për efekt të transparencës të verifikimit të mënyrës së llogaritjes së primit të sigurimit, duhet të evidentojë elektronikisht në mënyrë të dukshme të gjitha hallkat e ekzekutimit të programit për llogaritjen e primit, nga momenti fillestar i të dhënave analitike për depozitat dhe kreditë, deri në shumën përfundimtare të primit të sigurimit të depozitave.

#### ANEKSI 4

#### PARAMETRAT TEKNIKË QË DUHET TË PLOTËSOJË, DHE RAPORTET QË DUHET TË GJENEROJË SISTEMI INFORMATIK I BANKËS

Sistemi informatik i bankës duhet të mundësojë në çdo kohë vendosjen e parametrave të mëposhtëm:

- Shuma e mbulimit;
- Kursi zyrtar i këmbimit në ditën e vlerësimit;
- Kodin unik të identifikimit të depozituesit;
- Të gjitha kategoritë e produktit depozitë për depozituesin subjekt i skemës;
- Të gjitha kategoritë e produktit kredi për depozituesin subjekt të skemës;
- Detyrime të tjera të depozituesit ndaj të tretëve;
- Kushti përjashtues për interesin preferencial, i cili është 20 % më shumë se interesi i zbatuar sipas kushteve të punës për të gjithë depozituesit e tjerë.

Gjithashtu, sistemi informatik duhet të mundësojë në çdo kohë gjenerimin e raporteve të mëposhtme:

- Pozicionin e çdo depozituesi (individit) të bankës lidhur me:
  - a) depozitat e tij (secilën nga depozitat dhe të marra së bashku);
  - b) detyrimet ndaj bankës (kredi, overdraft, garanci etj., çdo detyrim më vete, si dhe të marra së bashku);
  - c) pozicionin neto të tij (depozita – kredi, të drejta – detyrime):
    - listën e plotë të depozituesve të bankës që janë subjekt i skemës së sigurimit të depozitave, së bashku me shumën përkatëse të depozitave të agreguara;
    - listën e depozituesve të bankës që nuk janë subjekt i skemës së sigurimit të depozitave sipas nenit 5 të ligjit nr.8873, datë 29.3.2002 “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar;
    - listën e depozitave që nuk përfshihen në skemën e sigurimit të depozitave sipas nenit 5 të ligjit nr.8873, datë 29.3.2002 “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar;

<sup>6</sup> Sipas vendimit të Këshillit Drejtues të ASD-së me akt nënligjor të Autoritetit Mbikëqyrës (norma e primit do të jetë jo më pak se 0.1% dhe jo më shumë se 0.7%).

- Konvertimin në lekë të të gjitha depozitave në monedhë të huaj me kursin zyrtar të këmbimit të përcaktuar nga Autoriteti Mbikëqyrës në ditën e vlerësimit kërkuar nga ASD-ja;
- Evidentimi i depozitave me interes preferencial, i cili është 20% më shumë se interesi i zbatuar sipas kushteve të punës për të gjithë depozituesit e tjerë;
- Listën e depozitorëve që kanë një detyrim kundrejt bankës, me shumën përkatëse të kredisë që ata kanë;
- Listën e depozitorëve që janë subjekt i skemës të sigurimit të depozitave pas bashkimit të cilësive të debitorit dhe kreditorit në një të vetëm, e shoqëruar me shumën përkatëse të depozitave të tyre krahasuar me nivelin e mbulimit;
- Raporte të ndryshme statistikore në varësi të situatave të ndryshme që do të paraqiten.

## ANEKSI 5

### KUSHTET ORGANIZATIVE BAZË QË DUHET TË PLOTËSOJNË SUBJEKTET

Subjektet që aplikojnë për t'u pranuar në skemën e sigurimit të depozitave, në zbatim të kritereve të ligjit nr.8873, datë 29.3.2002 "Për sigurimin e depozitave", të ndryshuar, duhet të plotësojnë kushtet organizative si më poshtë:

1. Të përfshijnë në kushtet e përgjithshme të punës dhe ato të veçanta për depozitat informacionin mbi:
  - sigurimin e depozitës (p.sh. informacionin mbi depozituesit dhe depozitat subjekt i skemës së sigurimit të depozitave, shumën e sigurimit etj.);
  - masën e kompensimit nga Agjencia;
  - kushtet dhe afatet e pagimit të kompensimit;
  - procedurat e sigurimit dhe kompensimit të depozitës;
  - rolin dhe qëllimin e veprimtarisë së Agjencisë.
2. Informacioni sipas pikës 1 shpallet në mjediset publike të bankës.
3. Ekspozimi në vende të dukshme i adezivëve me logon e ASD-së.
4. Shpërndarja e fletëpalosjeve, broshurave dhe materialeve të tjera promovuese të dërguara nga Agjencia, në të gjitha degët dhe agjencitë e bankës.

## ANEKSI 6

### KËRKESË

#### PËR PRANIMIN NË SKEMËN E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE DHE PAJISJEN ME CERTIFIKATË, NGA BANKAT DHE DEGËT E BANKAVE TË HUAJA QË KËRKOJNË TË LICENCOHEN PËR TË KRYER VEPRIMTARI BANKARE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Me anë të kësaj kërkesë i drejtohem Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, për sigurimin e depozitave sipas dhe deri në nivelet e depozitave të përcaktuara në ligjin nr.8873, datë 29.3.2002 "Për sigurimin e depozitave", i ndryshuar duke i vënë në dispozicion çdo informacion të kërkuar prej saj, për të na pajisur me certifikatë për sigurimin e depozitave.

Emri i bankës ose i degës së bankës së huaj

Banka/dega \_\_\_\_\_ sh.a.

Adresa \_\_\_\_\_

Numri dhe data e miratimit paraprak dhënë nga Autoriteti Mbikëqyrës \_\_\_\_\_

Dokumentacioni dhe deklarata që vërteton plotësimin e kushteve teknike dhe organizative sipas aneksit 2, 3, 4 dhe 5 të këtij udhëzimi.

Në aktivitetin që ne propozojmë të kryejmë angazhohemi për zbatimin e ligjit nr.8873, datë 29.3.2002 "Për sigurimin e depozitave", të ndryshuar dhe legjislacionin në Republikën e Shqipërisë.

Bashkëlidhur, do të gjeni informacionet për: kapitalin, aksionerët, administratorët, rrjetin e bankës, statutin, administratorët, si dhe planin e veprimtarisë.

Kërkuesit \_\_\_\_\_

Shënim: Kërkesa e shoqëruar me dokumentet dhe me formularët e kërkuar në mbështetje të këtij udhëzimi dërgohen në adresën e mëposhtme:



Agjencia e Sigurimit të Depozitave,  
Rruga e Elbasanit,  
Pallati pranë Ambasadës Amerikane, nr.317,  
Tiranë, Shqipëri.

Formulari nr.1 (vazhdim i aneksit nr.6)

Formulari nr.1: Kapitali i nënshkruar (i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit në momentin e plotësimit të kësaj kërkesë)

Nr.	Përshkrimi	Data dhe nr.i regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit	Shuma në lekë

Formulari nr.2 (vazhdim i aneksit nr. 6)

Formulari nr.2: Emrat e aksionerëve dhe pjesëmarrja në kapital (në shumë absolute dhe në përqindje).

Nr.	Emri, Mbiemri	Kombësia	Kapitali që zotëron	
			Shuma	Në %

Formulari nr.3 (vazhdim i aneksit nr.6)

Formulari nr.3: Administratorët e bankës ose të degës së bankës së huaj.

Emri mbiemri, emërtimi i detyrës si administrator dhe data e fillimit në detyrën si administrator.

Nr.	Emri mbiemri	Emërtimi i detyrës	Data e fillimit në detyrë

Formulari nr.4 (vazhdim i aneksit nr.6)

Formulari nr.4: Rrjeti i bankës ose i degës së bankës së huaj (degë e Agjencisë dhe vendndodhja e tyre në Republikën e Shqipërisë)

Nr.	Dega apo agjencia	Qyteti	Adresa e saktë

Për: Bankën ose degën e bankës së huaj

Kërkuesi \_\_\_\_\_

(Nënshkrimi dhe vula zyrtare e bankës)

Formulari nr.5 (vazhdim i aneksit nr. 6)

Formulari nr.5: Plani i përmbledhur i veprimtarisë.

Në planin e përmbledhur të veprimtarisë duhet të përfshihen:

1. Parashikimi i llojeve të depozitave që do të grumbullojë subjekti që do të aplikojë për bankë, gjatë tri viteve të para të veprimtarisë.

2. Përshkrimi i politikave dhe veprimtarive të huadhënies së bankës së propozuar, gjatë tri viteve të para të veprimtarisë.

3. Përshkrimi i burimeve kryesore të huas, si dhe metodat e ndryshme se si banka do t'i shfrytëzojë për të dhënë hua. Të tregohet deri në çfarë shkalle banka do të japë hua ose do të marrë pjesë në hua jashtë zonës kryesore ku kryen shërbimet bankare.

4. Përshkrimi i burimeve kryesore (kursimeve në formën e depozitave pa afat, të depozitave me afat, si dhe burime të tjera përdorimi, si dhe ndarja e depozitave sipas neneve 4 dhe 5 të ligjit nr.8873, datë 20.3.2002 "Për sigurimin e depozitave", të ndryshuar dhe të metodave për sigurimin e tyre etj.

5. Përshkrimi i llojeve të shërbimeve që banka do të ofrojë.

6. Statuti.

7. Administratorët e Bankës apo degës së bankës së huaj

8. Përshkrimi i aktiviteteve dhe shumat e investimeve në filiale për tri vitet e para të veprimtarisë.

9. Përshkrimi plotësisht për çdo investim të propozuar të pronave të patundshme, përveç atyre që përdoren për zyra ose për qëllime të tjera të përafërta.

Shënim. Kjo kërkesë paraqitet pranë Agjencisë së Sigurimit të Depozitave në adresën e mëposhtme:

Agjencia e Sigurimit të Depozitave,

Rruga e Elbasanit, nr. 317, pallati pranë Ambasadës Amerikane,

Tiranë, Shqipëri.

## ANEKSI 7

### KËRKESË

PËR AGJENCINË E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE LIDHUR ME PAJISJEN ME CERTIFIKATË TË RE PËR SIGURIMIN E DEPOZITAVE, NË RAST TË NDRYSHIMIT TË EMRIT OSE NË RAST TË RIORGANIZIMIT JURIDIK TË BANKËS OSE DEGËS SË BANKËS SË HUAJ OSE

Riorganizim juridik:

Ndryshim emri

\* Shëno më poshtë llojin e riorganizimit juridik

Bashkim me përthithje

Bashkim me krijim

Ndarje me krijim

Ndarje me përthithje

Emri i bankës së propozuar

Banka: \_\_\_\_\_

Adresa:

\_\_\_\_\_,  
Shqipëri (qyteti) (rrethi)

Me anë të kësaj kërkesë i drejtohem Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, duke i vënë në dispozicion çdo informacion të kërkuar prej saj, për të na pajisur me certifikatë të re për sigurimin e depozitave, me emërtimin e ri.

\_\_\_\_\_  
Kërkuesit

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

Shënim. Kërkesa e shoqëruar me dokumentet dhe me formularët e kërkuar në mbështetje të këtij udhëzimi dërgohen në adresën e mëposhtme:

Agjencia e Sigurimit të Depozitave.

Rruga e Elbasanit,

Pallati pranë Ambasadës Amerikane, nr.317, Tiranë, Shqipëri.

**Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-eksponitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.**  
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2011, është 16 000 lekë.  
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

#### BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI CIVIL	360 lekë
KODI I FAMILJES	310 lekë
KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	90 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KANONI I ZHURISË	40 lekë
PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS EUROPIANE	328 lekë
PËR TË DREJTAT E NJERIUT KUNDËR SHQIPËRISË	
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë
PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË	512 lekë

Hyri në shtyp më 13.4.2011  
Doli nga shtypi më 15.4.2011

Tirazhi: 1700 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare  
Tiranë, 2011

Çmimi 44 lekë